


REALIZIM I MËSIMIT TË ARSIMIT QYTETAR NË SHKOLLAT E MESME

Raport nga hulumtimi i realizuar





**United States
European Command**



**MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER**

Ky dokument është përgatitur nga ekipi i projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të Rinjëve në Arsim i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Byronë për Zhvillim të Arsimit, me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e dokumentit u përket autorëve dhe nuk shpreh pikëpamjet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Titulli:

REALIZIM I MËSIMIT TË ARSIMIT QYTETAR NË SHKOLLAT E MESME
Raport nga hulumtimi i realizuar

Botues:

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

Autorë:

Ajshe Ajrullai
Mitko Çeshllarov
Zhaneta Çonteva
Ana Mickovska Raleva

Dizajni:

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.5.035(497.7)"2019"(047)

REALIZIM i mësimit të arsimit qytetar në shkollat e mesme : raport nga hulumtimi i realizuar / [autorë Ajshe Ajrullai ... и др.]. - Shkup : Qendra maqedonase për edukim qytetar (QMEQ), 2020. - 50 стр. : илустр. ; 30 см

Други автори: Mitko Çeshllarov, Zhaneta Çonteva, Ana Mickovska Raleva. - Содржи и: Shembuj

ISBN 978-608-4529-83-5

1. Ajrullai, Ajshe [автор] 2. Çeshllarov, Mitko [автор] 3. Çonteva, Zhaneta [автор] 4. Mickovska Raleva, Ana [автор]
а) Граѓанско образование -- Средни училишта -- Македонија -- 2019 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 52153861

PËRMBAJTJE

1. HYRJE	5
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
2.1 METODA DHE INSTRUMENTE PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE	8
2.2 EKZEMPLAR	9
2.3 GRUMBULLIM, PËRPUNIM DHE ANALIZË TË TË DHËNAVE	11
3. ANALIZË E PROGRAMEVE MËSIMORE	12
4. REZULTATE NGA HULUMTIMI	18
4.1 PIKËPAMJE TË MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE PËR PROGRAMET MËSIMORE	18
4.2 PERCEPTIME TË MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE PËR METODAT E REALIZIMIT TË MËSIMIT	33
4.3 NOTIM I TË ARRITURAVE NGA ARSIMI QYTETAR	36
4.4 SHQYRTIM I MATERIALIALEVE PËR NXËNIE	38
4.5 PIKËVËSHTRIME TË MËSIMDHËNËSVE PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL	40
5. SHQYRTIM PËRMBLEDHËS I KONSTATIMEVE NGA HULUMTIMI	43
6. REKOMANDIME	45
SHEMBUJ	48



HYRJE



1. HYRJJE

Gjatë vitit 2017, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) filloi procesin e avancimit të përmbajtjeve të arsimit qytetar dhe vendosjes së metodave për nxitjen e përfshirjes aktive të nxënësve në aktivitete për ndryshime pozitive në suaza të shkollës dhe bashkësishtë..

Në bashkëpunim me projektin e USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsim (INRA) dhe projektin për *Përforcim të bashkëpunimit multietnik në komunat* të Fondacionit për Fëmijë Pestaloci, të cilat i realizon Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), punohet në avancimin e programeve mësimore dhe në përpilimin e kompetencave të cilat nxënësit duhet t'i përvetësojnë gjatë shkollimit të tyre. Këto kompetenca përkufizojnë se çfarë pritet që nxënësit të përvetësojnë në fund të çdo cikli arsimor në suaza të arsimit fillor dhe në fund të arsimit të mesëm. Kompetencat janë të grupuara si: njohuri dhe kuptime; shkathtësi (shkathtësi kognitive dhe shkathtësi për pjesëmarrje qytetare); qëndrime dhe vlera dhe sjellje qytetare.

Kompetencat qytetare janë shfrytëzuar si bazë për përkufizimin e rezultateve nga nxënia gjatë përpunimit të programeve të reja mësimore për arsim qytetar në klasën e tetë dhe të nëntë, si dhe gjatë përpilimit të programit të dizajnuar modular për vitin e parë të shkollave të mesme profesionale.

Për klasën e tetë dhe nëntë të arsimit fillor, në përputhje me programet e tyr, u përgatitën materialet për përkrahjet të mësimdhënies dhe nxënies së lëndës arsimit qytetar („Udhëzues për nxënës për klasën e tetë“ dhe „Doracak për mësimdhënës për klasën e nëntë“) u realizuan trajnime për konceptin e ri të arsimit qytetarë.

Në programin mësimor për arsimin e mesëm, temat, përkatësisht njësitet modulare përputhen me temat e programit mësimorë për klasën e tetë dhe të nëntë, përkatësisht me fushat e përmbajtjeve të arsimit qytetar, por ato janë thëlluar për sa i përket nivelit të rezultateve të pritura nga nxënia e nxënësve. Gjatë vitit 2018/2019 programi i dizajnuar modular u pilotua në tetë shkolla të mesme profesionale në vendin tonë. Ky proces i pilotimit dha mundësi të shkëlqyeshme për vendosjen e çështjeve hulumtuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, çështje me të cilat mund të përcaktohen përparësitë, gjegjësisht sfidat që i sjellë realizimi i programit më të ri të dizajnuar. Pilotimi gjithashtu ka edhe një përparësi, atë se rezultatet e fituara mund të krahasohen me dy grupet “kontrolluese” të nxënësve dhe mësimdhënësve të cilët punojnë sipas programeve të vjetra për arsim qytetar në shkollat e mesme profesionale dhe sipas programit të aktivitetit të projektit për kulturë qytetare në arsimin e gjimnazist. Sipas programit të vjetër arsimor, arsimit qytetarë mesohet në vitin e katër të shkollës së mesme profesionale.

QËLLIM I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit ishte që të përcaktohet gjendja aktuale në aspektin e planifikimit dhe realizimit të mësimin në lëndën arsimit qytetar dhe aktivitetin e projektit në lëndën kulturore qytetare në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut (profesionale dhe gjimnazet) në mënyrë që të përkufizohen drejtimit konkrete për përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe nxënies në orët e mësimin nga lënda mësimore arsim qytetar.

Hulumtimi është orientuar, para së gjithash, drejt dhënies së përgjigjes në pyetjet si vijon:

➔ Lëndë dhe program

Cilat janë perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve për nevojën e arsimit qytetar (i mësuar në mënyrë lëndore, mes-lëndore (mes më shumë lëndëve) dhe jashtëshkollre)?

Cilat janë perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve për rëndësinë e përmbajtjeve në pilot-programin mësimor (të dizajnuar në mënyrë modulare) të arsimit qytetar?

➔ Mësimdhënie dhe nxënie

Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me mundësinë e arritjes së niveleve të ndryshme të kompetencave qytetare të nxënësve?

- Metodatat dhe teknika për mësimdhënien dhe nxënien për arritjen e kompetencave
- Metoda dhe teknika për vlerësimin e arritjes së kompetencave


Cilat janë qëndrimet e nxënësve lidhur me mënyrat më adekuate të mësimdhënies dhe nxënies për përvetësimin e kompetencave qytetare?

➔ Zhvillim profesional

Çfarë trajnimesh kanë ndjekur mësimdhënësit e arsimit qytetar?

Cilat janë nevojat e trajnimeve të mësimdhënësve të arsimit qytetar?





METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi është me karakter eksplorativ (të konstatohet gjendja) dhe theksi është vënë në fushat si vijon:

Programet mësimore nga arsimit qytetar, para së gjithash në raport me:

- nevojën e lëndës mësimore dhe cilësinë e programeve mësimore
- rëndësinë e përmbajtjeve mësimore
- nevojën e përmirësimit të programeve mësimore
- nivelin e arritjes së qëllimeve për pjesëmarrje të nxënësve në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë.

Realizimi i mësimdhënies dhe nxënies, me ç'rast janë hulumtuar:

- metodat e realizimit të mësimdhënies
- mënyrat e mbështetjes së nxënies.

Shqyrtime të librave shkollorë, me ç'rast janë hulumtuar:

- gjykimet e mësimdhënësve dhe të nxënësve për librat shkollorë
- nevoja për materiale plotësuese.

Shqyrtimi i trajnimeve, nga aspekti i:

- cilësisë së trajnimeve të ndjekura, si dhe nevojës për zhvillim plotësues profesional dhe mbështetje profesionale.

2.1 Metoda dhe instrumente për grumbullimin e të dhënave

Në mënyrë përkatëse në kornizë konceptuale, në këtë hulumtim janë grumbulluar të dhëna prej mësimdhënësve që e kanë ligjruar lëndën arsim qytetar në vitin e parë në tetë shkollat profesionale në të cilat u pilotua programi i dizajnuar në mënyrë modulare në vitin shkollor 2018/19, arsim qytetar në vitin e katërt (për të gjitha profesionet, përveç atij ekonomik, juridik dhe tregtar), arsim qytetar për vitin e katërt (profesioni ekonomik, juridik dhe tregtar) dhe mësimdhënës të cilët e realizojnë aktivitetin e projektit të lëndës kulturre qytetare në arsimin e gjimnazist.¹

¹ Këta janë në të shumtën e rasteve mësimdhënës të cilët në drejtimet e gjimnazit ligjërojnë lëndën sociologji

Gjithashtu, të dhënat janë grumbulluar edhe nga nxënësit e vitit të parë në tetë shkollat profesionale në të cilat pilotohet programi i dizajnuar në mënyrë modulare i arsimit qytetar, si dhe nxënës të shkollave të tjera profesionale dhe gjimnazeve të cilët vlerësimet e tyre i mbështetnin në përvojën me përmbajtjet nga arsimit qytetar në klasën e tetë dhe të nëntë, si dhe në pritjet e tyre për atë se si duhet të realizohet arsimi qytetar në shkollat e mesme.

Për nevojat e këtij hulumtimi janë përpiluar pyetësorë dhe protokolle për udhëheqjen e grupeve të fokusit.

Të dhënat e grumbulluara janë sasiore dhe cilësore.

➔ Hulumtim i mësimdhënësve

Nga mësimdhënësit janë grumbulluar: gjykimet për programet mësimore dhe për librat shkollorë, të dhëna për metodat e realizimit të mësimit, për mënyrat e mbështetjes së nxënies të nxënësit, trajnime dhe nevojë për trajnime dhe vlerësime për nivelin e arritjes së qëllimeve të programeve mësimore. Të dhënat nga mësimdhënësit janë grumbulluar me „Pyetësor elektronik për mësimdhënës“, në platformën SurveyMonkey, për përgjigjen e të cilit nevojiteshin rreth 25 minuta, si dhe përmes diskutimeve në grupe të fokusit. Mësimdhënësit zgjedhën në cilën gjuhë do t'i përgjigjen pyetësorit, ishin ofruar gjuha maqedonase, shqipe dhe turke.

Në grupet e fokusit mësimdhënësit janë ndarë në grupe sipas gjuhës (maqedonisht, gjegjësisht shqip).

➔ Hulumtim i nxënësve

Nga nxënësit janë grumbulluar informacione dhe mendime për pyetje të ngjashme si ato për mësimdhënësit, në mënyrë që të sigurohet besueshmëri më e madhe e të dhënave. Ato janë grumbulluar me „Pyetësor elektronik për nxënës“ në platformën SurveyMonkey, për përgjigjen e të cilave nevojiteshin rreth 25 minuta, si dhe përmes diskutimeve në grupe të fokusit. Në tabelën e mëposhtme është dhënë përshkrim i çdo instrumenti që është i dobishëm në hulumtimin.

Nxënësit zgjedhën në cilën gjuhë do t'i përgjigjen pyetësorit, ishin ofruar gjuha maqedonase, shqipe dhe turke.

Në grupet e fokusit nxënësit janë ndarë në grupe sipas gjuhës (maqedonisht, gjegjësisht shqip).

Tabela nr. 1 Përshkrim i instrumenteve të shfrytëzuara në hulumtimin

Instrument	Përshkrim i shkurtër
Pyetësor elektronik për mësimdhënësit nga lënda e arsimit qytetar	Pyetësori për mësimdhënës përbëhet prej 54 pyetjeve të llojit të hapur dhe të mbyllur. Përgjigjja e pyetësorit ishte përmes mënyrës elektronike dhe anonime.
Protokoll për zhvillimin e diskutimit në grupin e fokusit me mësimdhënës	Protokolli përmbante drejtime për udhëheqjen e grupeve të fokusit dhe 17 pyetje udhëzuese për diskutim, në tema të ngjashme si në pyetësorin për mësimdhënës.
Pyetësor elektronik për nxënësit	Pyetësori për nxënës përbëhet prej 22 pyetjeve të llojit të mbyllur. Përgjigjja e pyetësorit ishte organizuar në shkollë, në klasë me kompjuterë, përmes mënyrës elektronike dhe anonime.
Protokoll për zhvillimin e diskutimit në grupin e fokusit me nxënës	Protokolli përmbante drejtime për udhëheqjen e grupeve të fokusit dhe 12 pyetje orientuese për diskutim, në tema të ngjashme si në pyetësorin.

2.2 Ekzemplar

2.1 Nxënës

Ekzemplari i nxënësve është zgjedhur në dy hapa. Së pari, të gjitha shkollat e mesme u grupuan në tri rajone: Lindor, Perëndimor dhe Shkup. Më pas, në kuadër të secilit rajon u zgjodhën shkolla, me ç'rast i kushtojë rëndësi distancës territoriale, gjuhës mësimore (të ketë nxënës të mësimin në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke), si dhe përfaqësimit adekuat të llojit të arsimit (profesional/ gjimnazist). Tetë shkollat (Teknik ndërtimtari: SHMNGJQSH „Zdravko Cvetkovski“ – Shkup (paralele maqedonase dhe shqipe); SHMK „Nikolla Karev“ – Strumicë; Teknik hotelier-turistik: SHMQSH „Llazar Tanev“ – Shkup, SHKTH „Vanço Pitosheski“ – Ohër; Elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë: SHMETQSH „Mihajlo Pupin“ – Shkup, SHMKT „Nace Bugjoni“ – Kumanovë (paralele maqedonase dhe shqipe); Teknik për mehatronikë industriale: SHMK „Kiro Spanxhov-Bërko“ – Kavadar dhe QSHKEM „Sh. Naumi i Ohrit“ – Ohër) në të cilat u pilotua programi i dizajnuar në mënyrë modulare, të gjitha ishin përfshirë në ekzemplarin me gjithsej 127 nxënës.

Në kuadër të shkollës sipas zgjedhjes së rastësishme është zgjedhur një paralele e vitit të parë e cila e plotësonte pyetësorin e dhënë në platformën SurveyMonkey.

Gjatë diskutimit në **5 grupe të fokusit** morën pjesë gjithsej **55 nxënës** (në Shkup tre grupe të fokusit dhe në Kumanovë dy) që e kanë ndjekur mësimin nga arsimit qytetar sipas programit mësimor të dizajnuar në mënyrë modulare.

Tabela nr. 2 Ekzemplarë sipas gjinisë së nxënësve

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Femra	263	35.9
Meshkuj	364	49.7
Nuk janë përgjigjur	106	14.5
Gjithsej	733	100

Tabela nr. 3 Ekzemplar sipas përkatësisë etnike të nxënësve

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
maqedonase	410	55.9
shqiptare	153	20.9
turke	38	5.2
serbe	9	1.2
rome	6	.8
boshnjake	6	.8
tjetër	5	.7
vllahë	1	.1
nuk janë përgjigjur	105	14.3
Gjithsej	733	100

Tabela nr. 4 Ekzemplar sipas vendbanimit të nxënësve

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
fshat	203	27.7
qytet	310	42.3
nuk janë përgjigjur	220	30.0
Gjithsej	733	100

Mësimdhënës

Pyetësorët për mësimdhënës janë vendosur në platformën e SurveyMonkey dhe mësimdhënësit e arsimit qytetar nga shkollat e zgjedhura të mesme, me korrespondencë zyrtare deri te drejtorët, janë lutur të përgjigjen. Janë përgjigjur 106 mësimdhënës (86,8 % ligjërojnë në gjuhën maqedonase, 10,4 % në gjuhën shqipe dhe 2,8 % në turqisht) prej 68 shkollave (gjysma e numrit të përgjithshëm

të shkollave të mesme në vendin tonë) që bën të ditur në përfaqësimin e ekzemplarit.

Prej tetë shkollave në të cilat u pilotua programi mësimor i dizajnuar në mënyrë modulare janë përgjigju gjithsej pesë arsimtarë nga shkollat vijuese: Teknik ndërtimtarie: SHMNGJQSH „Zdravko Cvetkovski“ – Shkup (paralele maqedonase dhe shqipe); SHMK „Nikolla Karev“ – Strumicë; Teknik hotelier-turistik: SHMQSH „Lazar Tanev“ – Shkup, „Nace Bugjoni“ – Kumanovë (paralele maqedonase dhe shqipe); dhe QSHKEM „Sh. Naumi i Ohrit“ – Ohër).

Më poshtë janë paraqitur të dhëna për strukturën arsimore dhe stazhin e punës të mësimdhënësve në ekzemplar. Struktura arsimore e mësimdhënësve nga lënda e arsimit qytetar në ekzemplarin përputhet me atë në popullatën, 64 % e mësimdhënësve në ekzemplarin janë me arsimin që përputhet me normativin për kuadër mësimor nga lënda.

Tabela nr. 5 Ekzemplarë sipas gjinisë së të anketuarve

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
femra	51	48.1
meshkuj	31	29.2
përgjigje joadekuata	3	2.8
nuk janë përgjigjur	21	19.8
Gjithsej	106	100

Tabela nr. 6 Ekzemplari sipas llojit të arsimit të mbaruar të kuadrit mësimor

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
studime të sociologjisë	55	51.9
studime të filozofisë	8	7.5
studime të historisë	5	4.7
tjetër*	8	7.5
nuk janë përgjigjur	30	28.3
Gjithsej	106	100

*Kategoria tjetër përfshin studime të Artit figurativ; Fakultetit Teologjik; Gjeografisë; Fakultetit Ekonomik; Fakultetit Pedagogjisë; Mbrojtjes; Pedagogjisë; Fakultetit të Shkencave Politike

Tabela nr. 7 Vite të përvojës në ligjërimin e lëndës arsim qytetar

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
1 vit	13	12.3
2-5 vite	15	14.2
6-10 vite	26	24.5
10+ vite	27	25.5
nuk janë përgjigjur	25	23.6
Gjithsej	106	100

Tabela nr. 8 Vite të përvojës në udhëheqjen e aktiviteteve të projektit nga kultura qytetare

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
1 vit	23	21.7
2-5 vite	18	17.0
6-10 vite	8	7.5
10+ vite	6	5.7
nuk janë përgjigjur	51	48.1
Gjithsej	106	100

Sipas të dhënave për stazhin e punës të arsimtarëve, në ekzemplarin konstatohet se gjysma e mësimdhënësve të arsimit qytetar kanë më shumë se 5 vite stazh.

Në raport me aktivitetet e projektit nga kultura qytetare, mund të vërehet se përqindja më e madhe mësimdhënësve (40%) kanë më pak se 5 vite stazh pune.

Në diskutimet në 4 grupe të fokusit kanë marrë pjesë gjithsej 36 mësimdhënës (nga Shkupi, Tetova, Gostivari dhe Kumanova), prej tyre 5 mësimdhënës kanë punuar sipas programit të dizajnuar në mënyrë modulare për arsim qytetar, 31 sipas programeve për arsim qytetar për arsimin e mesëm profesional dhe 5 sipas drejtimeve për realizimin e aktiviteteve të projektit nga arsimit qytetar.



2.3 Grumbullim, përpunim dhe analizë të të dhënave

Hulumtimin elektronik e organizoi dhe realizoi Byroja për Zhvillimin e Arsimit. Këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit i udhëhiqnin diskutimet në grupet e fokusit me mesimdhënësit, ndërsa diskutimet me nxënësit janë realizuar nga përfaqësuesit e Forumit Rinor Arsimor (FRA) në përputhje me protokollet për udhëheqjen e diskutimeve të përpiluara nga Byroja.

Të dhënat nga pyetësorët elektronik janë bartur në programin statistikor „Statistical Package for the Social Sciences (SPSS)“, që përdoret për përpunimin e përgjigjeve. Duke marrë parasysh karakterin e hulumtimit janë përdorur procedura nga statistika deskriptive.

Për diskutimet në grupet e fokusit janë mbajtur shënime të hollësishme, e më pas janë përpunuar me analizë tematike të përmbajtjes.

Me pyetësorin elektronik janë marrë përgjigje prej 106 mesimdhënësve prej gjithsej 68 shkollave të mesme dhe prej 733 nxënësve të 50 shkollave të mesme.

Hulumtimi elektronik është zbatuar gjatë muajit mars, të vitit 2019, ndërsa grupet e fokusit gjatë muajit qershor, të vitit 2019.

3. ANALIZË E PROGRAMEVE MËSIMORE

Arsimi qytetar në shkollat e mesme është i përfaqësuar dhe mësohet në dy mënyra të ndryshme, varësisht nga lloji i arsimit të mesëm.

Me reformat në arsimin gjimnazist në vitin 2002 nxënësve në kuadër të fushës „Aktivitete të projektit“, u ofrohet edhe mund të zgjedhin realizimin e aktiviteteve të projektit nga arsimit qytetar (me fond prej 36 orëve në vit). Synimi i aktiviteteve të projektit është që nxënësit të përfshihen në aktivitete hulumtuese dhe të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në gjithë procesin e zgjidhjes së problemit/temës në të cilën punojnë, përmes hulumtimit deri te prezantimi i problemit dhe kërkim të zgjidhjes/ndryshimit. Programi i përpunuar paraqet vetëm kornizën me udhëzime dhe propozim-tema dhe fusha të caktuara që nxënësit mund t'i zgjedhin dhe të punojnë me mbështetje të mësimdhënësit.

Me reformat në arsimin e mesëm profesional në vitin 2005, në planin mësimor vendoset lëndë e posaçme mësimore arsim qytetar me dy programe të ofruara mësimore, një për nxënësit e profesionit ekonomik, juridik dhe tregtar, ndërsa programi tjetër mësimor për të gjitha profesionet tjera. Lënda mësimore mësohet në vitin e katërt, me fond javor prej 2 orëve.

Me fillimin e procesit të reformave në vitin 2017 në mësimdhënien e arsimit qytetar, e veçanërisht me përpilimin e kompetencave për arsim qytetar, që paraqisnin bazë për përpunimin e programeve të reja mësimore për klasën e tetë dhe të nëntë në arsimin fillor, u mundësua vazhdimësi në mësimdhënien e arsimit qytetar në arsimin e mesëm.

Duke vepruar kështu, ndryshimet në mësimdhënien e arsimit qytetar filluan nga arsimit profesional katërvjeçar. Ky proces filloi në vitin shkollor 2018/2019 (në pilot shkollat) përmes ndryshimeve në planin arsimor, sipas të cilit lënda arsimi qytetarë nga viti i katërt, mësohet në vitin e parë, me çka sigurohet vazhdimësi në nxënie dhe në ndërtimin e diturive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve pas arsimit qytetar në shollë fillore. Nga viti shkollor 2019/2020 lënda arsim qytetarë mësohet në katër shkolla të mesme profesionale. Programi mësimor bazohet në rezultatet e nxënies, aktivitetet e ofruara dhe standardet e vlerësimit, ndërsa mbështetet në kompetencat e zhvilluara për arsim qytetar.

Parimi i njëjtë i përpunimit të programeve mësimore planifikohet të vazhdojë edhe në arsimin e gjimnazist dhe atij të artit, gjatë periudhës kur do të zhvillohen reforma në planet dhe programet mësimore, në përputhje me „Strategjinë për zhvillimin e arsimit 2018-2025“.

Në vazhdim vijon përshkrimi i programeve mësimore sipas të cilave zhvillohet mësimi në shkollat e mesme (te një pjesë e programeve të vjetra mësimore, duke marrë parasysh faktin se programi i ri vendoset në mënyrë suksesive prej vitit 2019/2020).

PROGRAM I DIZAJNUAR NË MËNYRË MODULARE PËR ARSIM QYTETAR PËR VITIN E PARË TË ARSIMIT KATËRVJEÇAR PROFESIONAL PËR TË GJITHA PROFILET

Sipas kornizës për përpunimin e programeve mësimore të dizajnuara në mënyrë modulare në arsimin profesional (Projekt: SKILSS – reforma në arsimin teknik profesional) programi është i strukturuar sipas elementeve vijuese: rezultate nga nxënia, përmbajtje dhe kuptime; aktivitete dhe metoda; dhe kriteret për vlerësim. Janë parashikuar gjithsej 72 orë në vit, gjegjësisht 2 orë në javë.

Programi mësimor është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës (nr. 13-4390/12 të 11.06. të vitit 2019. Mësimi nga arsimit qytetar, në përputhje me „Normativën për kuadër mësimor“, e realizon një arsimtar me studime të mbaruara nga sociologjia, historia dhe filozofia.

Njësitë modulare të programit mësimor janë:

Identitet qytetar – Pasqyrë për veten si qytetar, në këtë temë janë dhënë përmbajtjet si vijon:

- Vetëdije për identitetin qytetar
- Dallim dhe zhvillim të veçorive dhe shkathtësive personale
- Kontroll të sjelljes
- Etikë
- Shprehje të emocioneve

Lidhshmëri qytetare, në këtë temë janë dhënë përmbajtjet vijuese:

- Komunikim
- Shqyrtim të pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme
- Përkatësi ndaj bashkësisë
- Humanitet
- Pranim dhe respektim të diversiteteve
- Multikulturalizëm dhe jetesë e integruar
- Përballje me konflikte

Qytetar në shoqërinë qytetare, në këtë temë janë dhënë përmbajtjet si vijon:

- Roli i qytetarit në shoqëri
- Të drejta dhe përgjegjësi
- Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm
- Qytetari si novator dhe sipërmarrës
- Qytetari si konsumator dhe kursimtar
- Organizata qytetare dhe grupet e përfaqësimit
- Mediat në shoqërinë demokratike
- Religjioni në shoqëri

- Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor

Qytetari dhe shteti, në këtë temë janë dhënë përmbajtjet si vijon:

- Vlerat demokratike
- Pushteti në funksion të qytetarëve
- Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Sundimi i së drejtës
- Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri
- Roli shoqëror i shtetit dhe administratës publike

Qytetari dhe bota, në këtë temë janë dhënë përmbajtjet si vijon:

- Globalizim i shoqërisë
- Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare
- Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës

Rezultatet nga nxënia në program ndërlihen me standarde për arritjen e rezultateve nga nxënia. Rezultatet u referohen, gjegjësisht mbështeten në kompetencat themelore (dituri, shkathtësi, qëndrime, vlera, sjellje qytetar) që duhet t'i posedojnë nxënësit në arsimin e mesëm. Gjatë zhvillimit të programit mësimor, përveçse në arritjen e diturive nga fusha e arsimit qytetar, theksi është vendosur në zhvillimin e shkathtësive për interpretim, ndërtim të qëndrimeve, vlerave, koncepteve dhe nxitje të aksionit në shoqërinë qytetare.

Gjithashtu, mund të konstatohet se gjatë krijimit të programit, janë respektuar edhe angazhimet për krahasim ndërkombëtar të rezultateve nga nxënia e nxënësve, si dhe të praktikës ndërkombëtare në mësimdhënien e arsimit qytetar.

PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIM QYTETAR PËR VITIN E KATËRT PËR PROFESIONIN EKONOMIK, JURIDIK DHE TREGTAR NË ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL

Programi mësimor është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës (nr. 11-7307/1 të 02.10. të vitit 2008. Mësimdhënien nga arsimit qytetar, në përputhje me „Normativën për kuadër mësimor“, e realizon mësimdhënësi me studime të mbaruara nga sociologjia, filozofia, pedagogjia dhe historia. Ndryshimet dhe plotësimet e programit mësimor i miratoi ministri (nr.07-244/3 të 23.03. të vitit 2010).

Tërësi tematike të programit mësimor

Demokraci (16 orë)

- Demokracia përballë diktaturës dhe anarkisë
- Vlera demokratike (liri, përgjegjësi, drejtësi, barabarësi, ligjshmëri)
- Demokracia në RM
- Zgjedhje dhe sjellje në zgjedhje
- Sundim i shumicës dhe mbrojtje të minoriteteve
- Shtet demokratik, sovranitet, pushtet
- Pushtet dhe ndarje të pushtetit
- Nivel i pushtetit
- Sundim i së drejtës dhe shtet juridik
- Opinion dhe mendim publik: jetë publike dhe private
- Bashkësi qytetare: kuptime dhe elemente
- Informimi në shoqërinë demokratike
- Roli i masmediave në demokraci (llojllojshmëri, liri, pavarësi, përgjegjësi, saktësi e informacioneve)

Qytetari dhe të drejta dhe përgjegjësitë qytetare (13 orë)

- Njeriu si qytetar
- Të drejtat e njeriut: nocioni, kuptimi shoqëror, prejardhja dhe zhvillimi i idesë për të drejtat e njeriut
- Dimensionin ndërkombëtar i të drejtave të njeriut
- Të drejta dhe liri personale
- Të drejta dhe liri politike
- Të drejta dhe liri sociale, ekonomike dhe kulturore
- Të drejtat dhe liritë dhe zhvillimi shoqëror
- Lojaliteti qytetar, guximi qytetar
- Karakteristika të qytetarit të mirë (dituri, aftësi dhe qëndrime dhe që duhet t'i posedojë qytetari)

- Të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Shoqëria qytetare – ndryshime dhe sfida (9 orë)

- Popullatë, strukturë, lëvizje e popullatës
- Politikë demografike
- Planifikim i familjes
- Plakje e popullsisë, papunësi, pasuria përballë varfërisë
- Lëvizje të reja sociale (lëvizje femërore, feministe, ekologjike, paqësore)
- Veprim humanitar

Konfliktet në shoqërinë qytetare dhe zgjidhja e tyre (10 orë)

- Konflikt social
- Konflikte në shoqërinë dhe konflikte ndërshoqërore
- Dhunë dhe mënyrë paqësore, terrorizëm dhe antiterrorizëm
- Përballje me konfliktet
- Postkonflikti
- Paqe dhe tolerancë

Globalizim i shoqërive (12 orë)

- Kombi, nacionalizmi dhe qytetaria
- Ndërlidhja ndërkombëtare ekonomike
- Kombet e bashkuara
- Agjenci joqeveritare të ndërlidhjes
- Organizata të tjera internacionale
- Globalizim i mediave: lajme, kinema, TV, radio, reklamë, komunikim elektronik, Internet
- Evropa dhe integrimi i saj
- Institucione të Bashkimit Evropian
- Vlera evropiane dhe identitet evropian
- Sisteme kolektive të sigurisë
- Integrimi i Republikës së Maqedonisë² në Bashkimin Evropian

Zgjedhje dhe e drejta e zgjedhësve (6 orë)

- Zgjedhjet janë bazë për demokracinë (rëndësia dhe funksioni i zgjedhjeve)
- Sisteme zgjedhore dhe lloje të zgjedhjeve
- E drejta e zgjedhësve (përmes së cilës shprehet sovraniteti popullor)

Sipas kornizës për përpilimin e programit mësimor, programi përmban: tërësi tematike; qëllime konkrete; rekomandime didaktike dhe korelacion mes tërësive tematike dhe mes lëndëve. Programi nuk përmban nocione që do të duhet t'i aprovojnë nxënësit. Janë paraparë 66 orë mësimore në vit, gjegjësisht 2 orë në javë. Në pjesën e programit: Metoda mësimore dhe aktivitete të nxënies, bëhet e

ditur se për realizimin e qëllimeve detyrimisht duhet të zbatohen format dhe metodat interaktive, siç janë: puna në grupe, diskutime, debate, analiza të tekstit dhe dokumenteve, analiza të rastit, por edhe metodat tradicionale didaktike si: ligjërata, bisedë e orientuar dhe nxënie përmendësh. Nga nxënësit pritet të identifikojnë probleme, të zbatojnë hulumtime personale dhe grupe, të shkruajnë ese, të përpunojnë portofole, të analizojnë informacione prej burimeve të ndryshme. Nga mësimdhënësi pritet të jetë organizator, koordinator, instruktor, t'i individualizojë detyrat, duke i përshtatur me interesat, mundësitë intelektuale dhe pritjet e nxënësve.

PROGRAMI MËSIMOR I ARSIMIT QYTETAR PËR VITIN E KATËR PËR TË GJITHA PROFILET E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËRVEÇSE PËR PROFILET NGA PROFESIONI EKONOMIK, JURIDIK DHE TREGTAR

Programi mësimor është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës (nr. 11-1471/4 të 16.10. të vitit 2001. Mësimin e arsimit qytetar, në përputhje me „Normativën për kuadër mësimor“, e realizon mësimdhënësi me studime të mbaruara nga sociologjia, filozofia, pedagogjia dhe historia. Ndryshimet dhe plotësimet e programit mësimor i miratoi ministri (nr.07-244/3 të 23.02. të vitit 2010).

Tërësi dhe përmbajtje tematike të programit mësimor:

Njeri, shoqëri, kulturë (13 orë)

- Njeriu – qenie natyrore dhe shoqërore
- Individu dhe shoqëria
- Si i hulumtojmë individin dhe shoqërinë (metodologjia)
- Kulturë
- Religjione
- Socializim/Shoqërizim
- Përrjashtime (devijime) shoqërore

Grupim shoqëror (13 orë)

- Unë në mesin e të tjerëve (bashkëveprim)
- Role shoqërore
- Grupet në shoqëri
- Familje
- Grupe të pozicionit (shtresim dhe lëvizshmëri)
- Grupe etnike
- Barazi mes gjinive

2 Името на државата се користи како што е наведено во соодветните документи.

Unë qytetari (20 orë)

- Çfarë jemi si qytetarë dhe shtetas?
- Shteti, sovraniteti, pushteti
- Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut
- Rendi demokratik politik
- Prezantim politik: zgjedhjet dhe partitë politike
- Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Unë pronar, prodhues, konsumator (9 orë)

- Nevojat, puna, prodhimtaria, konsumi
- Ndarja shoqërore e punës dhe specializimi ekonomik
- Pronësi dhe kapital
- Tregu dhe para
- Shteti dhe tregu – ekonomi sociale e tregut
- Ndërmarrje

Jeta sociale dhe politika sociale (5 orë)

- Popullatë
- Politikë demografike
- Mbrojtje sociale dhe politikë sociale
- Ekologji-mbrojtje të mjedisit jetësor
- Veprim humanitar

Ne në Evropë dhe botë (6 orë)

- Bota bashkëkohore dhe globalizimi i saj
- Evropa dhe integrimi i saj
- Maqedonia në Evropë dhe botë

Zgjedhje dhe të drejtat e zgjedhësve (6 orë)

- Zgjedhjet janë bazë për demokracinë (rëndësia dhe funksioni i zgjedhjeve)
- Sisteme zgjedhore dhe lloje të zgjedhjeve
- Të drejtat e zgjedhësve (përmes të cilave shprehet sovraniteti popullor)

Sipas kornizës program mësimor, programi përmban: tërësi tematike; qëllime konkrete, rekomandime didaktike; dhe korelacion mes tërësive tematike dhe mes lëndëve. Programi nuk përmban nocione që duhet t'i përvetësojnë nxënësit. Janë paraparë gjithsej, 66 orë në vit, respektivisht 2 orë në javë.

Në pjesën e programit: Metoda mësimore dhe aktivitete të nxënies bëhet e ditur se për realizimin e qëllimeve nga programi mësimor është shumë e rëndësishme qasja metodike gjatë përpunimit të përmbajtjeve mësimore. Rekomandohet përdorim i teknikave: sociodramë, diskutim, debat, stuhi idesh, analizë të tekstit dhe dokumenteve, analizë të rastit, katrore, pazëll, pesërreshtash, grumbull, prizëm, guri që flet, Diagram i Venit. Në

programin, gjithashtu bëhet e ditur se duhet të ketë përpilim të detyrave individuale të shtëpisë (hulumtime, portofole, ese).

UDHËZIME PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT KULTURË QYTETARE

Në materialin e përgatitur për mësimdhënësit të cilët janë të obliguar në realizimin e aktiviteteve të projektit nga fusha e kulturës qytetare janë përpunuar disa aspekte: nevoja për vendosjen e aktiviteteve të projektit nga fusha e arsimit qytetar, qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të këtij lloji të aktivitetit të projektit, fusha dhe tema të mundshme, mënyra e organizimit dhe realizimit.

Qëllime:

- Të përvetësohen përvijat praktike që i avancojnë kompetencat dhe efikasitetin e tyre
- Të zhvillojnë shkathtësi për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve
- Të ndikojnë në pushtetin gjatë marrjes së vendimeve
- Të dinë t'i mbrojnë të drejtat qytetare
- Të mësohet se si të shprehin mendimin e tyre
- Të dinë të përpunojnë plan të aktiviteteve
- Të zhvillojnë shkathtësi për punë grupore
- Të ndërtojnë ndjenjën e përgjegjësisë në grup
- Të dinë të përdorin literaturë dhe informacione për një problem të caktuar
- Të dinë të përzgjedhin informacione
- Të ndërtojnë kulturë të të folurit, shkruarit dhe interpretimit.

Fusha dhe tema:

- Demokracia në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Të drejtat e njeriut
- Të drejtat dhe detyrat qytetare
- Punësim, papunësi, varfërim, migrime
- Kulturë e jetesës, stile të jetës
- Kulturë, pluralizëm kulturor
- Jeta sociale – politika sociale
- Vlera, norma, zakone
- Shfrytëzimi i kohës së lirë në mënyrë racionale
- Devijime shoqërore
- Zgjidhje e konflikteve
- Ndikimi i mas-mediave dhe të rinjtë (televizioni dhe dhuna, mediat e reja elektronike, bota e virtualitetit)
- Religjioni në shoqëritë bashkëkohore (lëvizje të reja religjioze)
- Keqpërdorimi i fëmijëve
- Planifikimi i familjes
- Trafikimi i njerëzve

- Sjellje e dhunshme e të rinjve
- Keqpërdorim i të rinjve për qëllime politike
- Të rinjtë dhe morali
- Veprimi humanitar
- Barazia mes gjinive

Aktivitetet mund të realizohen në shkollë dhe jashtë saj, në institucione përkatëse.

Gjatë realizimit të programit nxënësit do të kenë rastin të zbatojnë metoda bashkëvepruese të punës dhe teknika bashkëkohore të nxënies.

Mësimdhënësi duhet të mbajë llogari nëse janë të përfshirë të gjithë nxënësit në përputhje me aftësitë dhe interesat e tyre dhe nëse kanë qasje në aktivitetin e përgjithshëm të projektit. Nëse nxënësi sërish e zgjedhë fushën kulturore qytetare, problemi hulumtues duhet të vendoset në nivel më të lartë, gjegjësisht duhet të thellohet pjesa për udhëheqjen e projekteve (hulumtime rrënjësore), ndërsa nxënësit të orientohen drejt hulumtimit të çështjeve më komplekse nga problemi i hulumtuar.





REZULTATE NGA HULUMTIMI

4. REZULTATE NGA HULUMTIMI

4.1 Pikëpamje të mësimdhënësve dhe nxënësve për programet mësimore

Mësimi sipas programit të dizajnuar në mënyrë modulare për arsim qytetar për herë të parë është realizuar gjatë vitit shkollor 2018/19 si program eksperimental në tetë shkolla të mesme profesionale; programi për arsim qytetar për të gjitha profilet e arsimit të mesëm profesional përveç profileve arsimore nga profesioni ekonomik, juridik dhe tregtar realizohet që nga viti 2002; programi për arsim qytetar për arsim profesional për profesionin ekonomik, juridik dhe tregtar prej vitit 2008; ndërsa aktivitetet e projektit për kulturë qytetare në arsimin e gjimnazist prej vitit 2000/2001.

Përvojat nga pilotimi i programit të dizajnuar në mënyrë modulare në vitin shkollor 2018/19 shfrytëzohen si bazë për të shqyrtuar përparësitë dhe mangësitë e programit, krahasuar me përvojën shumëvjeçare të mësimdhënësve nga realizimi i arsimit qytetar në vitin e katërt të arsimit të mesëm profesional, si dhe në raport me përvojën e nxënësve në mësimin e arsimit qytetar në klasën e tetë dhe të nëntë, sipas programeve të vjetra mësimore që nuk janë të dizajnuara në bazë të trendeve bashkëkohore të kompetencave qytetare.

Pikëpamjet për programet mësimore në hulumtim janë grumbulluar nga: 1) mësimdhënësit të cilët ligjërojnë lëndën dhe të cilët realizojnë aktivitete të projektit; 2) prej nxënësve të vitit të parë që e kanë ndjekur lëndën arsim qytetar (sipas programit të dizajnuar në mënyrë modulare), si dhe nxënës të vitit të parë që nuk e kanë mësuar lëndën, por kanë përvojë nga arsimi fillor dhe pritje për atë se si duhet të mësohet arsimi qytetar në shkollat e mesme.

Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur gjykimet e tyre që janë marrë përmes përgjigjes në pyetjet në pyetësorin dhe të shprehura gjatë diskutimeve në grupet e fokusit. Gjykimet janë grupuar në dy fusha tematike: 1) Gjykime të përgjithshme për lëndën mësimore dhe programin mësimor dhe 2) Gjykime për përmbajtjet mësimore.

4.1.1 Pikëpamje të përgjithshme për lëndën mësimore dhe për programin mësimor

Vlerësime të nxënësve për përvojat dhe shkathtësitë e përvetësuar nga arsimi qytetar nga klasa e tetë dhe nëntë

Nxënësit janë pyetur që të vlerësojnë përvojën e tyre nga mësimdhënia e lëndës mësimore arsim qytetar në klasën e tetë dhe të nëntë, nga aspekti i dimensioneve vijuese: pozitivitet, dobi, sa i kompluar dhe mërzitshëm është.

Vlerat mesatare (mesataret aritmetike) janë përllogaritur në një shkallë e cila lëvizë prej 1 deri 10 me ç'rast 1 shënon shumë negative, ndërsa 10 shumë pozitive (të koduara anasjelltas për shkallët për matjen e peshës dhe mërzisë: 1 shënon lënda ishte shumë e vështirë, ndërsa 10 lënda ishte shumë e lehtë, gjegjësisht 1 shënon lënda nuk ishte shumë e mërzitshme, ndërsa 10 lënda ishte shumë e mërzitshme) dhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 9 Vlera mesatare e shkallëve për vlerësimin e përvojës së nxënësve me lëndën arsim qytetar në shkollën fillore

Dimensione	Mesatarja aritmetike
Pozitivitet	7,6
Dobi	7,5
Peshë	7,8
Mërzi	6,5

Sipas rezultateve të paraqitura mund të vërehet se nxënësit kanë pasur përvojë pozitive me lëndën mësimore arsim qytetar në arsimin fillor, se të njëjtën e kanë vlerësuar si lëndë të dobishme, relativisht interesante dhe relativisht të lehtë.

Lidhur me atë se cilat shkathtësi i kanë përvetësuar nxënësit me mësimin e lëndës në klasën e tetë dhe të nëntë, nxënësit gjithashtu vlerësonin në shkallën prej 1 deri 10, me ç'rast 1 shënon nuk i përvetësua fare deri 10 i përvetësua në masë të madhe. Nxënësit kanë vlerësuar se në masë të konsiderueshme (nota mesatare 7) i kanë përvetësuar shkathtësitë kryesore qytetare për: identifikimin e nevojave të bashkësisë, inicim të aktiviteteve për përmirësimin e bashkësisë dhe planifikim të aktiviteteve për përmirësimin e bashkësisë.

Tabela nr. 10 Vlera mesatare e shkallëve për vlerësim të shkathtësive të përvetësuar të nxënësve me lëndën arsim qytetar në shkollën fillore

Shkathtësi të përvetësuar	Mesatarja aritmetike
Identifikim i nevojave të bashkësisë (ekologjike, sociale, arsimore))	7
Inicim të aktiviteteve për përmirësimin e bashkësisë (p.sh. ekologjike, humanitare, aksione artistike)	7
Planifikim i aktiviteteve për përmirësimin e bashkësisë (p.sh. ekologjike, humanitare, aksione artistike)	6,9

Vlerësime të mësimdhënësve për aftësitë e tyre për realizimin e mësimdhënies

Lidhur me përgatitjen, gjegjësisht aftësitë e mësimdhënësve për realizimin e arsimit qytetar, shumica e arsimtarëve konsiderojnë se studimet i kanë aftësuar tërësisht me: njohuri përkatëse dhe kuptim të përmbajtjeve nga arsimi qytetar (59,4 % tërësisht, pjesërisht 27,4 %, nuk i kanë aftësuar 1,9 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur), njohuri dhe kuptim të metodave të ndryshme të mësimdhënies për arritjen e qëllimeve nga arsimi qytetar (50,9 % tërësisht, pjesërisht 33 %, nuk i kanë aftësuar 4,7 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur), si dhe me njohuri për ndjekjen dhe vlerësimin e qëndrimeve, vlerave, sjelljes së nxënësve (50,9 % tërësisht, pjesërisht 34 %, nuk i kanë aftësuar 2,8 %, 12,3 % nuk janë përgjigjur), por më pak me dituri, gjegjësisht shkathtësi që të përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies për arritjen e qëllimeve nga arsimi qytetar (45.3 % tërësisht, pjesërisht 39.6 %, nuk i kanë aftësuar 3,8 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur) dhe më së paku me njohuri për gjetjen e burime/materiale përkatëse për mbështetjen e mësimdhënies dhe nxënies (materiale për mësimdhënësit dhe materiale për nxënësit) (43,4 % tërësisht, pjesërisht 39,6 %, nuk i kanë aftësuar 4,7 %, 12,3 % nuk janë përgjigjur). (Grafiku nr. 1)


E ngjashme është situata edhe në raport me efektet nga praktika e deritanishme mësimore mbi aftësimin e mësimdhënësve për realizimin e arsimit qytetar. Praktika ka kontribuar që ata të aftësohen me njohuri dhe kuptimin e përmbajtjeve nga arsimi qytetar (70,8 % tërësisht, pjesërisht 18,9 %, nuk i ka aftësuar 0 %, 10,4 % nuk janë përgjigjur), por edhe me shkathtësinë për të ndjekur dhe vlerësuar/notuar qëndrimet, vlerat, sjelljen e nxënësve (62,3 % tërësisht, pjesërisht 26,4 %, nuk i ka aftësuar 0.9 %, 10,4 % nuk janë

përgjigjur), si dhe me njohuri dhe kuptimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies për arritjen e qëllimeve nga arsimi qytetar (58, 5 % tërësisht, pjesërisht 28,3 %, nuk i ka aftësuar 1,9 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur), por më pak për shkathtësi për gjetjen e burimeve/materialeve përkatëse për mbështetjen e mësimdhënies dhe nxënies (materiale për mësimdhënësit dhe materiale për nxënësit) (53, 8 % tërësisht, pjesërisht 34 %, nuk i ka aftësuar 0,9 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur) dhe më së paku me shkathtësi për të përdorur metoda të ndryshme të mësimin për arritjen e qëllimeve nga arsimi qytetar (52.8 % tërësisht, pjesërisht 35.8 %, nuk i ka aftësuar 0 %, 11,3 % nuk janë përgjigjur).

Këto të dhëna bëjnë të ditur në atë se praktika mësimore e mësimdhënësve është më e rëndësishme sesa arsimi formal (inicial) nga aspekti i aftësimin të tyre për realizimin e mësimdhënies në arsimin qytetar. Informata se programet studimore nuk kontribuojnë mjaftueshëm në mënyrë që mësimdhënësit të përvetësojnë kompetenca për mësimdhënie të arsimit qytetar bëjnë të ditur në domosdoshmërinë e rishikimit të tyre dhe harmonizimin me qasjet bashkëkohore në arsimin qytetar.

Në grafikun më poshtë janë paraqitur rezultatet për kategorinë e përgjigjes „tërësisht më ka aftësuar“ (nga aspekti i studimeve dhe praktikës së deritanishme mësimore).





Grafiku nr. 1 Vlerësim i mësimdhënësve lidhur me aftësitë për realizimin e arsimit qytetar (%)

4.1.2 Pikëpamje të nxënësve dhe mësimdhënësve për nevojën e arsimit qytetar në shkollat e mesme

Në pyetjen nëse në arsimin e mesëm duhet të mësohen përmbajtje nga arsimit qytetar, 57,2% e nxënësve kanë dhënë përgjigje pohuese. Përqindja është diçka më e madhe (66 %) kur të merren parasysh përgjigjet vetëm nga nxënësit që e kanë mësuar lëndën në vitin e parë sipas programit të dizajnuar në mënyrë modulare. Kjo e dhënë mund të dëshmojë për atë se këta nxënës kanë tendencë ta shikojnë dobën nga mësimi i arsimit qytetar, që mund të ndërlidhet me zbatimin e përmbajtjeve nga programi në jetën e përditshme të nxënësve. Perceptimi i këtillë është i mbështetur në diskutimet në grupet e fokusit me nxënës (Shiko nëntitullin: Pikëpamje për programin e ri modular).

Lidhur me formën e mësimin të përmbajtjeve nga arsimit qytetar, mësimdhënësit (63,2%)³

janë të pajtimit se arsimit qytetar duhet të mësohet si lëndë e veçantë mësimore në të gjitha shkollat e mesme. Një përqindje më e vogël e mësimdhënësve (15,1 %) konsiderojnë se përmbajtjet mund të mësohen në formë të aktivitetit të projektit, përqindja e njëjtë (15,1 %) e mësimdhënësve konsiderojnë se arsimit qytetar mund të mësohet edhe përmes përfshirjes së nxënësve në punën e bashkësisë së nxënësve. Një përqindje e vogël e mësimdhënësve (5,7 %) janë përgjigjur se arsimit qytetar mund të mësohet si aktivitet jashtëshkollor, gjegjësisht në mënyrë të integruar përmes lëndëve të tjera mësimore (1,9 %). Të dhënat bëjnë të ditur në faktin se mësimdhënësit nuk janë mjaftë të sensibilizuar për mënyrat e ndryshme në të cilat mund të përvetësohen kompetenca qytetare dhe kanë tendencë që të fokusohen në lëndën mësimore, si formë primare e mësimin.

Lidhur me atë se çfarë duhet të mësohet nga arsimit qytetar, përgjigjet e nxënësve dhe mësimdhënësve janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Sipas nxënësve, më e rëndësishme është të mësohet për të drejtat dhe mbrojtjen e tyre, sesa të përvetësohen shkathtësi qytetare për marrjen e vendimeve, argumentim, gjykimeve dhe nxjerrjen e konstatimeve. Vetëm një e pesta e nxënësve kanë vlerësuar se në orët e arsimit qytetar mund të mësohet për atë se si të përfshihen në mënyrë më aktive në shkollë përmes marrjes së vendimeve të rëndësishme për ta. Të dhënat e marra nga nxënësit bëjnë të ditur në faktin se ata mendojnë në mënyrë mjaftë konvencionale dhe se duhet të punohet në ndryshimin e qëndrimeve të tyre. Megjithatë, mungesa e materialeve mësimore që kanë të bëjnë me programin e ri modular i detyron mësimdhënësit të përkushtojnë thuajse tërë orën në përvetësimin e përmbajtjeve përballë zhvillimit të shkathtësive dhe nxitjes së sjelljes qytetare.

Rezultatet e fituara nga hulumtimi elektronik, mund të mbështeten me të dhënat nga diskutimet në grupet e fokusit me nxënësit. Nxënësit që mësojnë arsim qytetar, sipas programit të ri modular kanë theksuar se për shkak të faktit se nuk kanë libër shkollor për arsim qytetar në një pjesë të orëve ata shpesh kanë qenë të nxitur që vetëm t'i dëgjojnë mësimdhënësit, t'i shënojnë "pikat kryesore" nga diktimi dhe të njëjtën ta mësojnë përmendësh:

„Ajo që duhet ta mësojmë ta dimë profesoresha na e dikton që ta shënojmë në fletore. Ndërsa, ajo që diktohet është shumë

³ Се однесува генерално, на различните наставни програми што се во употреба.

e pamjaftueshme. Vetëm pika të shkurtra. I gjithë programi është shumë i ngjeshur dhe nuk ka kohë të mjaftueshme që të sqarohet ose të realizohet ndonjë ushtrim i mirë që do të lërë diçka te ne. Nuk ka kohë për atë.“

„Profesoresha nga njohuritë e saj, bën si tekst-plan leksion dhe na e transmeton neve. Ajo dikton, ne shkruajmë dhe nga kjo mësojmë. Plus, nuk është interesante vetëm të dëgjohet. Profesoresha na dikton definicione, ndërsa ne shënojmë.“


Mësimdhënësit, gjithashtu, në përqindje të madhe konsiderojnë se arsimit qytetar është i nevojshëm që nxënësit të mësojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen e tyre, por edhe për atë se si të përfshihen në përmirësimin e bashkësisë (70,8 %). Kjo e dhënë e marrë nga mësimdhënësit është argument shumë i rëndësishëm për mësimin proaktiv të lëndës, por qëndrimi i këtyre të mësimdhënësve është i pamjaftueshëm nëse ata në praktikë, gjatë orëve dhe aktiviteteve jashtëshkollore, nuk praktikojnë përfshirje reale të nxënësve në përmirësimin e bashkësisë.

Mësimdhënësit, si edhe nxënësit, e shikojnë më pak lidhshmërinë mes arsimit qytetar dhe forcimit të shkathtësive për argumentim, nxjerrjen e konstatimeve, pjesëmarrjen në marrjen e vendimeve, që janë në fakt kompetenca kryesore qytetare.

Tabela nr. 11 Sfidat/vështirësitë kryesore me të cilat përballen mësimdhënësit gjatë realizimit të mësimin të lëndës arsimit qytetar/aktivitete të projektit nga kultura qytetare

Kategori të përgjigjes	Numër	Përqindje
Mungesë e librave përkatës shkollor, doracakëve, ushtrimeve	15	13,2
Problem hapësinor, nuk kemi klasë të pajisur me materiale për IKT (standarde të pasiguruara për hapësirë dhe pajisje)	6	5,7
Shumë paranjohuri të dobëta të nxënësve nga arsimiti fillor	4	3,8
Një numër i vogël i nxënësve, nuk janë të motivuar dhe janë të ngarkuar me një numër të madh të lëndëve/orëve mësimore	4	3,8
Pamundësia për të realizuar një pjesë të vogël të aktiviteteve të parashikuara, siç janë vizitat në institucione relevante, që ndonjëherë nuk janë të hapura dhe të kapshme për bashkëpunim	4	2,8
Të kuptuarit e aktivitetit të projektit kulturë qytetare, si lëndë për përllogaritje/për fond të orëve/, nevojitet korelacion në normativin për kuadër mësimor	4	2,8
Disa tema, si për shembull: Unë qytetari, nuk janë përkatëse me moshën e nxënësve (në vitin e parë)	2	1,9
Pak orë për përmbajtje aq voluminoze	2	1,9
Gjatë përkthimit të teksteve në gjuhën shqipe ka shumë gabime	1	0,9
Mungesë e trajnimeve për mësimdhënësit	1	0,9
Pa përgjigje	63	59,4
Gjithsej	106	100





Grafiku nr. 2 Qëndrime të mësimdhënësve dhe nxënësve për përmbajtjet që duhet të mësohen nga Arsimi qytetar

4.1.3 Sfida në realizimin e programit mësimor nga arsimit qytetar

Lidhur me çështjen e sfidave kryesore me të cilat përballen mësimdhënësit gjatë realizimit të programeve⁴, rezultatet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Shumica e mësimdhënësve nuk kanë përmendur sfida konkrete, që mund të dëshmojë për harmonizimin e kërkesave të programeve me mundësitë dhe pritjet e mësimdhënësve. Megjithatë, prej sfidave të përmendura vërehet se sfidë më e madhe për mësimdhënësit është mungesa e resurseve, gjegjësisht librave përkatës shkollor dhe doracakëve për realizimin e mësimin. Vijon problemi hapësinor me të cilin përballen mësimdhënësit, gjegjësisht mungesa e klasës përkatëse për realizimin e mësimin.

⁴ Се однесува генерално, на различните наставни програми што се во употреба.

4.1.4 Vlerësime për programin e ri modular i arsimit qytetar për shkollat e mesme profesionale

Mësimdhënësve u janë parashtruar pyetje: **Sa jeni të njoftuar me programet e reja për arsim qytetar në arsimin katërvjeçar të mesëm profesional në mësimin eksperimental 2018/2019?** Sipas të dhënave të marra, numri më i madh i mësimdhënësve kanë vetëm njohuri të pjesërishtme për programin e ri ose nuk janë të njoftuar fare me të njëjtin.

Tabela nr. 12 Numër i mësimdhënësve të njoftuar me programet e reja për arsim qytetar në arsimin e mesëm katërvjeçar profesional në mësimin eksperimental 2018/2019

Kategori të përgjigjes	Numër	Përqindje
jam mirë i/e njoftuar	15	14.2
kam disa njohuri	44	41.5
nuk jam i/e njoftuar	38	35.8
nuk janë përgjigjur	9	8.5
Gjithsej	106	100

Lidhur me vlerësimin e programit, mësimdhënësit që kanë ligjëruar sipas **programit modular**, në diskutimet në grupet e fokusit e kanë shkëmbyer përvojën e tyre, nga aspekti i asaj se programi i ri i nxitë nxënësit të jenë në qendër të nxënies, gjë që gjithsesi kërkon shumë më tepër angazhim edhe nga vetë mësimdhënësi.

„Nxënësit shumë më lehtë e ndërlihdin materialin mësimor me përvojat e tyre dhe materiali është lehtë i kuptueshëm. Programi i ri modular i motivon shumë më tepër nxënësit, më shumë i aktivizon nxënësit, nxënësit mendojnë më shumë, diskutojnë më shumë, i shtyn të kritikojnë, të ndërtojnë qëndrime, orët janë shumë më interesante.“

„Programi i ri e detyron mësimdhënësin të jetë proaktiv dhe duhet të hulumtojë vazhdimisht, të kërkojë diçka të re, nuk e le “të flejë”, e stimulon të lexojë, të jetë në rrjedhë dhe i jep liri më të madhe.“

Lidhur me fondin e orëve, mësimdhënësit konsiderojnë se dy orë mjaftojnë, por si sfidë e kanë shprehur mungesën e librit shkollor, si dhe mjetet plotësuese financiare për

aktivitete plotësuese për realizimin e qëllimeve të programit.

„Për programin e ri modular mjaftojnë dy orë, por sfida më e madhe është ajo se nuk ka libër shkollor.“

„Lidhur me aktivitetet plotësuese, nevojiten mjete financiare. Nevojitet ditë jomësimore pune për aktivitete të projektit dhe aktivitete jashtëshkollore nga fusha e arsimit qytetar.“

„Nevojitet motivim për praktika të suksesshme.“

Një numër i vogël i mësimeve konsiderojnë se programi ndoshta më shumë u konvenon nxënësve të vitit të katërt, sesa për nxënës të vitit të parë (konsiderojnë se nxënësit e vitit të parë nuk do të diskutojnë lirshëm). Këtë mendim, arsimtarët me siguri e mbështesin në përvojën e tyre të deritanishme të përpunimit të përmbajtjeve nga arsimit qytetar me nxënës të vitit katërt të cilët nuk kanë pasur përvojë në pjesëmarrjen aktive në orët e arsimit qytetar në shkollat fillore (pjesëmarrje në vendimmarrje, diskutime, propozimin e zgjidhjeve, pjesëmarrje në ndërmarrjen e aksioneve për ndryshim, etj.).

Në kuadër të diskutimeve në grupet e fokusit, nxënësit që kanë ndjekur mësim sipas programit të dizajnuar në mënyrë modulare janë pyetur se çfarë mendojnë ata për lëndën arsimi qytetar, nga aspekti i asaj se çfarë u pëlqen, gjegjësisht çfarë nuk u pëlqen. Nxënësit e veçojnë realizueshmërinë e lëndës në jetën e përditshme, mënyrën përkatëse të sjelljes, komunikimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, etj.

„Arsimi qytetar është lëndë interesante, na mëson për gjëra interesante nga përditshmëria, për konfliktet, për identitetin, moralin, etikën, paqen dhe kulturën...“

„Na mëson nëse veprimet tona dhe ato të ardhme janë të sakta. Na udhëzon të mendojmë drejt, të punojmë në grupe si tërësi, të pajtohemi me njëri-tjetrin.“

„Të bëhemi versioni më i mirë i vetvetes.“

Këto perceptime konfirmojnë se nxënësit e kanë kuptuar thelbin e programit të ri mësimor dhe fokusin e saj në shkathësitë, vlerat dhe sjelljen qytetare. Megjithatë, disa nxënës të caktuar bëjnë të ditur se zbatimit praktik të diturisë i kushtohet vëmendje e pamjaftueshme.

„Sipas meje, kultura qytetare është me rëndësi të madhe, ndërsa ne fëmijët tani nuk e kemi përvetësuar, meqë edukata shtëpiake është në nivel shumë të ulët. Por,

mendimi im është se lënda nuk është përsosur dhe zhvilluar sa duhet për ta arritur qëllimin e dëshiruar. Arsimit qytetar nuk duhet të paraqesë leksion që të mësohet për notë. Për shembull, çfarë është kultura dhe të jepet përkufizim, por të jepet ndonjë pjesë praktike dhe zbatim në praktikë. Pa mësim praktik, vetëm mësojmë përkufizime përmendësh, ndërsa kjo nuk është interesante dhe askush nuk është i interesuar.“

Ajo që nuk u pëlqen nxënësve është mënyra në të cilën është vendosur lënda mësimore në disa shkolla të mesme në të cilat pilotohej programi modular.

Ata nuk kanë qenë të informuar me kohë se do të mësojnë lëndën në vitin e parë, nuk i është kushtuar kujdes orarit të tyre të orëve, ndërsa kjo veçanërisht ka të bëjë me nxënësit të cilët udhëtojnë për disa kilometra për të mbërritur deri në shkollë.

„Na e sollëm lëndën në fillim të vitit, na e futën disi në orar edhe para edhe pas orëve. Kjo shkakton problem, veçanërisht për ne që udhëtojmë. Për shembull, unë për shkak të arsimit qytetar të premtën kam shtatë orë dhe më duhet çdoherë të lirohem për të kapur autobusin ose trenin për të shkuar në shtëpi. Edhe për profesorët është problem. Profesoresha është në ndërrim të ndryshëm prej nesh dhe tërë kohën jemi në kontakt me të, për të parë nëse do të kemi orë ose jo.“





4.1.5 Vlerësime për programet e vjetra mësimore të arsimit qytetar dhe kulturës qytetare

Mësimdhënësit të cilët punojnë sipas programve të **arsimit qytetar prej vitit 2002 dhe 2008 dhe në aktivitetet e projektit për kulturë qytetare** kanë bërë të ditur se në programet ka më shumë teori sesa aktivitete dhe nëse mësimdhënësit u përmbahen atyre, mësimi duhet të zhvillohet në mënyrë klasike. Lidhur me programin për aktivitet të projektit mësimdhënësit janë shprehur se realizimi, gjegjësisht se gjithçka varet nga kreativiteti i mësimdhënësit. Gjithashtu, mësimdhënësit kanë theksuar se aktivitetet e projektit u janë ndarë mësimdhënësve të cilët nuk janë sipas normativit dhe se në disa shkolla nuk janë realizuar fare aktivitete të projektit nga kultura qytetare.

4.1.6 Qëndrime të nxënësve për përmbajtjet mësimore të arsimit qytetar

Programi i ri i dizajnuar në mënyrë modulare ofron përmbajtje që nuk ishin të përfshira në programet paraprake mësimore. Për shkak të kësaj, ishte me rëndësi të përcaktohet se sa nxënësit i konsiderojnë të përshtatshme përmbajtjet nga programi dhe sa janë të interesuar që t'i mësojnë ato. Rezultatet lidhur me pyetjen: **Shëno nëse dhe sa do të doje të mësohesh për përmbajtjet vijuese** që janë paraqitur në Tabelën nr. 13. Nga ajo që është paraqitur mund të vërehet se nxënësit do të donin t'i mësojnë shumë përmbajtjet: Humanitet (76,2 %), Komunikim (76,2 %), Jetesë e shëndoshë (74,2, %), derisa përmbajtjet: Mediat në shoqëri demokratike (29,4 %), Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri (27 %) dhe Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut (24,8 %) nuk do të donin t'i mësojnë.

Tabela nr. 13 Paraqitje e temave/përmbajtjeve nga arsimi qytetar, sipas asaj nëse dhe sa duan nxënësit t'i mësojnë

Kategori të përgjigjeve	Do të doja	Nuk do të doja	Nuk kam qëndrim	Nuk janë përgjigjur
Humanitet	76.2	6.5	2.9	14.3
Komunikim	76.2	6.5	2.9	14.5
Jetesë e shëndoshë	74.2	7.1	2.7	16.0
Kontroll i sjelljes personale	74.1	9.2	3.1	13.5
Pjesëmarrje e të rinjve në vendimmarrje në shkollë dhe bashkësi	70.1	10.5	4.4	15.6
Të drejta dhe përgjegjësi	70.1	11	4.5	14.3
Dallim dhe zhvillim i veçorive dhe shkathtësive personale	72.2	9.7	4.4	13.8
Pranim dhe respektim i diversiteteve	69	11.1	5.9	14.1
Ndërgjegjësim për veten si qytetar	68.6	9.7	8.2	13.5
Përballje me konflikte	65.5	15.3	5.2	14.1
Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor	64.1	14.5	6.8	14.6
Shqyrtim i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme	64.1	15.6	6.5	13.6
Roli i qytetarit në shoqëri	64	15.4	0.5	14.1
Religjioni në shoqëri	63.3	16.6	4.5	15.6
Etika	62.7	14.8	8.3	14.2
Sundim i së drejtës	61.9	15.9	7.2	14.9
Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës	60.8	15.9	7.8	15.4
Devijimet shoqërore (p.sh. sjellja e dhunshme, keqpërdorimi i drogës, alkoolizmi) dhe parandalimi i tyre	59.9	16.8	8.2	15.1
Përkatësi ndaj bashkësisë	59.5	16.8	9.4	14.3
Globalizimi dhe shoqëria	58.8	17	8.5	15.7
Multikulturalizmi dhe jetesa e integruar	58	16.5	11.3	14.2
Shprehja e emocioneve	57.1	20.2	7.8	14.9
Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm	57	18.5	9.4	15.0
Qytetari si konsumator dhe kursimtar	56.3	21.2	8.5	13.9
Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare	56.3	19.7	8.9	15.1
Pushteti në funksion të qytetarëve	53.6	22.2	8.6	15.6
Vlerat demokratike	51	23.6	10.4	15.0
Organizatat ndërkombëtare dhe grupet e përfaqësimit	50.8	23.7	10.9	14.5
Roli shoqëror i administrates shtetërore dhe publike	49.4	24.4	11.6	13.6
Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri	49	27	8.3	15.7
Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut	48.9	24.8	11.2	15.1
Mediat në shoqërinë demokratike	45.6	29.4	10.1	14.9

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve=733).

Përmbajtjet që nxënësit i kanë veçuar se do të donin shumë t'i mësojnë janë të përfshira në mënyrë solide në programin e ri mësimor modular të arsimit qytetar. Kështu për shembull, përmbajtjet humanitet dhe komunikim mund të gjenden si të integruara në përmbajtjet nga njësia e parë modulare, por edhe si përmbajtje të veçanta në njësinë e dytë modulare të programit mësimor. Megjithatë, edhe përmbajtjet që për nxënësit janë më pak atraktive janë pjesë e programit të ri, ndërsa nxënësit që punojnë sipas të njëjtit kanë përmendur se u janë të ndërlidhura dhe vështirë të kuptueshme.

Në diskutimet e grupeve të fokusit nxënësit kanë vërtetuar se duan të punojnë në tema që u janë të afërta, që kanë të bëjnë me jetën e tyre të përditshme, lidhur me familjen, miqtë, pranimin dhe dhënien e ndihmës për të tjerët. Veçanërisht si interesante e kanë theksuar përpunimin e përmbajtjes që ka të bëjë me multikulturalizmin dhe jetesën e integruar:

„Më së shumti më pëlqen kur flasim për familjen, miqtë, religjionet...“

„Më interesante më ishte tema për kulturën, etnitetet, për shkak se jetojmë në shoqëri multietnike, të njoftohemi me kultura të ndryshme dhe të bëjmë analogji me botën reale.“

Si **sfidë për nxënien** nxënësit kanë veçuar përmbajtjet që kanë të bëjnë me ndarjen e pushtetit, funksionimin e shtetit, partitë politike, etj. Sfidë plotësuese për ta paraqet edhe mënyra e punës gjatë orëve, gjegjësisht kur nuk merret parasysh përvoja, të menduarit e tyre dhe ndërlidhja me shembuj nga jeta e përditshme.

„Më së vështiri e kam t'i kuptoj organet shtetërore, si funksionojnë. Nuk më vjen interesant, jam në vitin e parë, dhe në fillim fokusohemi më shumë në lëndë të tjera më të rëndësishme, e jo në këtë.“

„Politikën nuk e kuptojmë, nuk është për moshën tonë. Politika është më e mërzitshmja. Çdo ditë në televizion politikë. Nga të kthehesh majtas-djathtas politikë. Në shkollë, në orë, sërish politikë. Nuk jemi në atë moshë që të lodhemi me politikë.“

„Materiali është si përsëritje nga fillorja. Ka diçka të ndryshme, por është si nga Wikipedia. Është i mërzitshëm. Për shembull, tema për korrupsionin ishte shumë e mërzitshme, meqë kur u bë fjalë për shembuj ku ka korrupsion u ndalëm në shembullin nga libri shkollor, e jo në pasqyrën e mirëfilltë ku takohet korrupsioni. Gjithçka ishte vetëm nga libri. E jo se ne nuk dimë ku ka, por nuk guxojmë të themi të gjitha vendet ku ka korrupsion.“

Si **tema plotësuese që do të mund të përfshihen në mësimin nga arsimit qytetar** nxënësit propozojnë përmbajtje që janë të ndërlidhura me sfidat e përditshme jetësore me të cilat përballen. Ato përfshijnë: jetesë të qëndrueshme, sajber siguri, arsim seksual, sjellje me respekt, etj.

„Sjellja ndaj individëve më të moshuar. Të rinjtë nuk dinë se si të sillen në këtë shoqëri.“

„Theks më i madh në ekologji.“

„Përdorim i sigurt i internetit.“

„Duhet të përfshihet temë për të ardhmen. Si të përballemi, si të përballemi në mënyrë reale ekonomike në këtë shtet. Si të përballemi në jetë vetë pa pasur lidhje njoftësie. Si të orientohemi, si të mbijetojmë pa pasur dikë që të na ndihmojë. Nuk kemi idenë se si të gjindemi.“

„Arsim seksual, aksione ekologjike dhe feminizëm.“

Ndonëse një pjesë e këtyre përmbajtjeve janë pjesë e programit modular, ekziston besueshmëria që nxënësit të mos i kenë mësuar sa duhet ose nga ana tjetër, i kanë mësuar në mënyrë joadekuate dhe të pandërlidhura me jetën e përditshme.

Në diskutimet në grupet e fokusit nxënësit janë pyetur lidhur me atë se **cilat përmbajtje i nxisin të mendojnë, të diskutojnë në shtëpi, me miqtë dhe ngjashëm**, si tregues të përmbajtjeve që nxisin motivim të brendshëm për nxënie të pavarur. Ata i kanë përmendur përmbajtjet që kanë të bëjnë me:

„zgjedhjet e gabuara që mund t'i bëjnë të rinjtë (alkool, cigare, drogë), zgjidhje të konflikteve, tolerancë dhe si të pajtohemi me të tjerët.“

Arsimtarët-pjesëmarrës në grupet e fokusit kanë vërejtur se disa përmbajtje të caktuara nga programi i ri modular nuk janë të nevojshme, meqë tashmë janë të njohura për nxënësit. Për shembull, tema “Biznes” (unë pronar, prodhues, konsumator) konsiderojnë se nuk nevojitet në programin e arsimit qytetar, e veçanërisht jo në shkollat profesionale ekonomike. Gjithashtu, përmbajtjet që kanë të bëjnë me demokracinë, sipas disa mësimeve, nuk nevojiten për shkak të paranjohurive të mjaftueshme të nxënësve për temën nga arsimit fillor. Programi i ri mësimor e ka parasysh edhe atë se përmbajtja për vlera demokratike përfshin një pjesë të vogël të programit.

Sipas mësimdhënësve, për nxënësit më interesante janë përmbajtjet: përballje me konflikte, paqe, tolerancë, të drejta dhe liri të njeriut.

„Sipas programit të ri modular, nxënësit janë të interesuar kur diskutohet për religjion, media, pjesëmarrje.“

„Kohëve të fundit temë më interesante për nxënësit është integrimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në raport me integrimet euroatlantike.“

„Lidhur me aktivitetet e projektit, nxënësit janë të interesuar më së shumti për: narkomaninë, alkoolizmin dhe dukuritë devijuese dhe temat nga kultura.“

Mësimdhënësit propozojnë që mësimi të plotësohet me përmbajtje që kanë të bëjnë me sajber dhunë, përdorim kritik të mediave (arsimim mediatik), si dhe tema që kanë të bëjnë me lëvizjet shoqërore, globalizimin dhe sjelljen kolektive.

4.1.7 Nevojë për mbështetje për realizimin e përmbajtjeve nga programi mësimor

Duke marrë parasysh se mësimdhënësit që ligjërojnë arsim qytetar vijnë me paranjohuri të ndryshme arsimore nga arsimi formal, ishte me rëndësi të përcaktohet nevoja e mbështetjes në realizimin e përmbajtjeve që janë pjesë e programit të ri modular. 30-40% e mësimdhënësve kanë deklaruar se nuk kanë nevojë për mbështetje në realizimin e përmbajtjeve. Megjithatë, thuajse gjysma kanë deklaruar se kanë nevojë për mbështetje (të madhe ose të pjesërishtme) në realizimin e përmbajtjeve vijuese: Pushteti në funksion të qytetarëve, Roli shoqëror i shtetit dhe administrata publike, Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm, Organizata qytetare dhe grupe të përfaqësimit, Përballje me konflikte, Kontroll i sjelljes, Qytetari si konsumator dhe kursimtar.

Mësimdhënësit kanë nevojë më të vogël për mbështetje në raport me përmbajtjet: Komunikim, Etikë, Vlera demokratike, Të drejta dhe përgjegjësi (Tabela nr. 14).



Tabela nr. 14 Niveli i mbështetjes së nevojshme që mësime dhënësit t'i realizojnë në mënyrë përkatëse përmbajtjet vijuese në mësim nga lënda e arsimit qytetar

Kategori të përgjigjeve	Më nevojitet mbështetje më e MADHE	Më nevojitet mbështetje e PJESËRISHME	NUK më nevojitet mbështetje	Nuk janë përgjigjur
Të drejta dhe përgjegjësi	13.2	22.6	40.6	23.6
Sundim i së drejtës	11.3	28.3	35.8	24.5
Kontroll i sjelljes	11.3	27.4	35.8	25.5
Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës	11.3	25.5	38.7	24.5
Roli i qytetarit në shoqëri	10.4	27.4	35.8	26.4
Pushteti në funksion të qytetarëve	10.4	35.8	26.4	27.4
Roli shoqëror i administratës shtetërore dhe publike	10.4	34.0	30.2	25.5
Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare	10.4	32.1	33.0	24.5
Shprehje e emocioneve	9.4	27.4	36.8	26.4
Mediat në shoqëri demokratike	9.4	28.3	37.7	24.5
Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor	9.4	24.5	41.5	24.5
Etniciteti	8.5	22.6	41.5	27.4
Multikulturalizmi dhe jetesa e integruar	8.5	31.1	34.9	25.5
Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm	8.5	36.8	27.4	27.4
Organizatrat qytetare dhe grupet e përfaqësimit	8.5	38.5	30.2	25.5
Ndërgjegjësim për identitetin qytetar	7.5	36.8	32.1	23.6
Komunikim	7.5	18.9	48.1	25.5
Vlera demokratike	7.5	28.3	40.6	23.6
Shqyrtim i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme	7.5	32.1	35.8	24.5
Humanitet	7.5	20.8	46.2	25.5
Pranim dhe respektim i diversiteteve	7.5	27.4	40.6	24.5
Dallim dhe zhvillim i veçorive dhe shkathtësive personale	6.6	35.8	32.1	25.5
Përkatësi ndaj bashkësisë	6.6	35.8	32.1	25.5
Qytetari si konsumator dhe kursimtar	6.6	41.5	25.5	26.4
Religjioni në shoqëri	6.6	32.1	35.8	25.5
Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut	6.6	26.4	42.5	24.5
Globalizimi i shoqërisë	5.7	28.3	39.6	26.4
Përballje me konflikte	4.7	37.7	31.1	26.4
Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri	4.7	25.5	44.3	25.5

Përqindja e përgjigjeve në secilën kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve =106)

Këto të dhëna bëjnë të ditur se mësimitdhënësit janë mjaft vetëkritik në raport me njohjen e disa përmbajtjeve të caktuara që janë karakteristike për programin e ri, ndërsa nuk janë të përfaqësuar në programet paraprake. Në mënyrë plotësuese, ata kanë edhe vështirësi në gjetjen e materialeve përkatëse dhe relevante për nxënie.

Duke marrë parasysh se libri shkollor për arsim qytetar për vitin e IV për shkolla të mesme profesionale është lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2010, nuk është harmonizuar me programin e ri mësimor, nuk i ka të gjitha njësitet mësimore nga programi dhe ka një temë më tepër në raport me programin (Jetë sociale dhe politikë sociale), mësimitdhënësit kërkojnë mbështetje plotësuese në formë të doracakut me aktivitete kreative për nxënësit dhe video të shkurtra meqë nxënësit më shumë duan të mësojnë në mënyrë vizuale. Në tabelën e mëposhtme është dhënë një paraqitje komparative e përmbajtjeve nga programi i dizajnuar mësimor modular përballë përmbajtjeve në librin shkollor.



Tabela nr.15 Paraqitje komparative e përmbajtjeve mësimore nga arsimi qytetar

Programi mësimor i dizajnuar mënyrë modulare	Libër shkollor për arsim qytetar
Titulli i temave dhe përmbajtjeve/mësimet në librin shkollor	
<p>Identiteti qytetar – Shfaqje për veten si qytetar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërgjegjësim për identitetin qytetar ➤ Dallim dhe zhvillim i veçorive dhe shkathtësive personale ➤ Kontroll i sjelljes ➤ Etikë ➤ Shprehje e emocioneve 	<p>Njeri, shoqëri, kulturë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Njeriu si qenie natyrore dhe shoqërore ➤ Individidi dhe shoqëria ➤ Si i hulumtojmë individin dhe shoqërinë ➤ Kulturë ➤ Identitet kulturor, relativizëm kulturor, etnocentrizëm ➤ Vlera, norma, zakone ➤ Religjion ➤ Socializim/Shoqërizim ➤ Devijime shoqërore (devijime)
<p>Lidhshmëri qytetare:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Komunikim ➤ Shqyrtim i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme ➤ Përkatësia ndaj bashkësisë ➤ Humanitet ➤ Pranim dhe respektim i diversiteteve ➤ Multikulturalizmi dhe jetesa e integruar ➤ Përballje me konflikte 	<p>Grupim shoqëror</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Unë në mesin e të tjerëve ➤ Rolet shoqërore ➤ Grupet në shoqërinë ➤ Familje ➤ Grupe të pozitive (shtresa dhe mobilitet) ➤ Grupe etnike ➤ Dallime të seksit dhe gjinive
<p>Qytetar në shoqërinë qytetare</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Roli i qytetarit në shoqëri ➤ Të drejta dhe përgjegjësi ➤ Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm ➤ Qytetari si novator dhe sipërmarrës ➤ Qytetari si konsumator dhe kursimtar ➤ Organizata qytetare dhe grupet e përfaqësimit ➤ Mediat në shoqëritë demokratike ➤ Religjioni në shoqëri ➤ Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor 	<p>Unë qytetari</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Çfarë jemi si qytetarë dhe shtetas ➤ Çfarë është pushteti dhe pse shërben ➤ Të drejta dhe liri themelore të njeriut ➤ Të drejta dhe liri qytetare dhe politike ➤ Të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore ➤ Demokracia dhe karakteristikat themelore të saj ➤ Shtetet demokratike dhe format tjera të rregullimit shtetëror ➤ Shoqata qytetare ➤ Prezantim politik – zgjedhje ➤ Sistem politik i R. Maqedonisë
<p>Qytetari dhe shteti</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlera demokratike ➤ Pushteti në funksion të qytetarëve ➤ Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut ➤ Sundim i së drejtës ➤ Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri ➤ Roli shoqëror i administratës shtetërore dhe publike 	<p>Unë, pronar, prodhues, konsumator</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Nevojat, puna, prodhimtaria dhe konsumi ➤ Ndarja shoqërore e punës dhe specializimi ekonomik ➤ Pronësi dhe kapital ➤ Tregu dhe paratë ➤ Shteti dhe tregu ➤ Lloje të ndërmarrjeve
<p>Qytetari dhe bota</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Globalizimi dhe shoqëria ➤ Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare ➤ Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës 	<p>Ne në Evropë dhe botë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bota bashkëkohore dhe globalizmi i tij ➤ Evropa dhe integrimi i saj ➤ Maqedonia në Evropë dhe botë
	<p>Jetë sociale dhe politikë sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Popullatë, strukturë, lëvizje ➤ Politikë demografike (planifikim i familjes) ➤ Mbrojtje sociale dhe politikë sociale ➤ Sigurim social ➤ Ekologji-mbrojtje të mjedisit jetësor ➤ Veprim humanitar

4.1.8 Shqyrtim i nivelit të arritjes së qëllimeve për pjesëmarrje të nxënësve në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë

Qasja e re në mësimdhënien e arsimit qytetar përmban qëllime që nënkuptojnë dalje nga qasja tradicionale e mësimdhënies teorike të përmbajtjeve dhe kërkojnë praktikim real të shkathtësive qytetare dhe sjelljes në kuadër të klasës, shkollës dhe bashkësisë. Për shkak të kësaj, është shqyrtuar se sa, në përgjithësi, nxënësit janë të përfshirë në aktivitete për ndryshimin pozitiv në bashkësi.

Lidhur me nxënien e arsimit qytetar përmes angazhimit në bashkësi, nxënësit në një përqindje më të vogël (21 %) janë prononcuar se ndonjëherë kanë marrë pjesë në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë (aksione ekologjike, humanitare, artistike).

Tabela nr. 16 Nxënës të cilët ndonjëherë kanë marrë pjesë në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë në të cilën jetojnë

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
PO	153	20.9
JO	481	65.6
Nuk janë përgjigjur	99	13.5
Gjithsej	733	100

Nga nxënësit që janë përgjigjur me "Po" është kërkuar që të shkruajnë se kur dhe në çfarë aktiviteteve kanë marrë pjesë. Sipas përgjigjeve që janë marrë, 61 nxënës kanë marrë pjesë në aksione ekologjike, ndërsa 46 nxënës në aksione humanitare, në pjesën më të madhe në bashkëpunim me Kryqin e Kuq.

Në diskutimet në grupet e fokusit nxënësit që punojnë sipas programit të ri modular kanë theksuar se gjatë vitit shkollor shumë pak kanë qenë të nxitur që të ndërmarrin aksione për përmirësimin e bashkësisë, ndonëse programi përmban rezultate të këtyra nga nxënësia (si për shembull: Nxënësi/ja është i/e aftë të: vlerësojë rëndësinë e përkatësisë ndaj bashkësisë dhe përfitimet e bashkësisë nga individët në ndërtimin e vlerave të përbashkëta, ndërlidhë humanitetin, të drejtat e njeriut dhe të drejta ndërkombëtare humanitare me pozitën e kategorive të rrezikuara të njerëzve dhe angazhohet për respektimin e tyre; të dallojë rolin e tij/saj si qytetar dhe të identifikojë mundësitë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore).

„Nuk kemi dëgjuar për aktivitete që të ndihmojmë në bashkësinë, ato informata nuk kanë mbërritur deri te ne.“

„Në fillore iniciativa për pastrimin e oborrit dhe mjedisit. Më pas aksion humanitar për romët. Por, nuk ka kurrfarë nismash nga lënda.“

Megjithatë, nxënësit konsiderojnë se mund të organizohen aktivitete për përmirësimin e bashkësisë dhe kanë ide të ndryshme për atë se si mund të realizohet.

„Arsimi qytetar është botë reale dhe duhet të kemi kulturën dhe të dalin nga korniza e lëndës. Çdo dy javë të ketë ndonjë mësim praktik lidhur me përpunimin praktik të ndonjë teme, si ndonjë punëtori. Dhe kjo ndoshta do t'i nxisë edhe shkollat tjera që të ndërlidhen, të bëhet diçka interesante, të përfshihen në aktivitetin.“

„Përmbajtjet nga arsimi qytetar na nxisin pak që të marrim pjesë në aktivitete të këtyra. Më shumë ka diskutim, por këtë nuk mund ta zbatojmë. Për shembull, për riciklimin ose për mbrojtjen e kafshëve. Do të ishte mirë që të jemi të nxitur nga shkolla që të bëjmë shoqatë, meqë nuk dimë ku të drejtohem nëse duam të përfshihemi në ndonjë zgjidhje.“

Mësimdhënësit konsiderojnë se me nxitjen e nxënësve të përfshihen në punën e shoqatave/organizatave të ndryshme (Kryqi i Kuq, klube, qendra për fëmijë/rini) (64,2 %), si dhe përmes inkurajimit të nxënësve për të marrë pjesë në punën e bashkësisë së nxënësve (52,8 %) mund ta mbështesin nxënien për arsim qytetar. Megjithatë, nëse merren parasysh përgjigjet e nxënësve, ata e nxisin mjaftueshëm pjesëmarrjen e nxënësve në forma të ndryshme që u janë në dispozicion.

Në këtë kontekst, diskutimet në grupet e fokusit tregojnë se mësimdhënësit të cilët punojnë sipas **programit modular për shkolla të mesme profesionale** theksojnë se ai ofron më shumë mundësi që nxënësit t'i kuptojnë problemet me të cilat përballet bashkësia (shkolla dhe bashkësia lokale), t'i dallojnë zgjidhjet e problemeve dhe të përfshihen në aktivitete të bashkësisë. Ata konstatojnë se programi i ri mësimor modular i motivon shumë më tepër nxënësit, i aktivizon më shumë nxënësit, nxënësit diskutojnë, kritikojnë, ndërtojnë qëndrime, por mungojnë mjete financiare për realizimin e këtij lloji të aktiviteteve në bashkësi.

Krahasuar me ta, mësimdhënësit të cilët punojnë **sipas programit të vjetër** konsiderojnë se në program ka më shumë teori sesa aktivitete dhe nëse mësimdhënësit i

përmbahen atij mësimi duhet të zhvillohet në mënyrë klasike.

„Duhet të pranojmë se programi aktual mësimor u jep tepër pak mundësi nxënësve për t'i udhëzuar drejt aktiviteteve që konkretisht do t'i demonstrolin rezultatet nga nxënia, gjegjësisht qëllimet që do të ishin fokusuar drejt vlerave, sjelljes, nismave të nxënësve.“

„Kryesisht programi mësimor është i fokusuar më shumë në njohuritë teorike sesa në demonstrimin e asaj që është mësuar.“


Mësimdhënësit të cilët e realizojnë **programin për aktivitete të projektit nga kultura qytetare** theksojnë se gjithçka varet nga kreativiteti i mësimdhënësit dhe se gjithçka që bëhet, bëhet në mënyrë praktike. Mësimdhënësit si shembull pozitiv për aktivitetin e projektit të orientuar drejt ndihmës në bashkësi e kanë theksuar aktivitetin e projektit të karakterit humanitar, ku nxënësit organizojnë mbledhjen e veshmbathjes dhe donimin/dhurimin familjeve në rezik social që realizohet në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale.

Tabela nr. 17 Mënyrat në të cilat mësimdhënësit mund të mbështetin “nxëniën për arsim qytetar”, përmes aktiviteteve jashtë mësimi të rregullt

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Përmes nxitjes së nxënësve që të përfshihen në punën e shoqatave/organizatave të ndryshme (p.sh. Kryqi i Kuq, klube, qendra për fëmijë/rini)	68	64,2
Përmes inkurajimit të nxënësve të marrin pjesë në punën e bashkësisë së nxënësve	56	52,8
Përmes organizimit të ligjëratave plotësuese, debateve, diskutimeve	50	47,2
Përmes organizimit të takimeve me ekspertë për ndonjë temë nga programi	45	42,5
Diçka tjetër (përmendni)*	2	1,9

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve =106)

*Debate, oratori; Përmes takimit me ekspertë për ndonjë temë të programit.



4.2 Perceptime të mësimdhënësve dhe nxënësve për metodat e realizimit të mësimin

Në pjesën e programeve mësimore në të cilat janë dhënë aktivitete dhe metoda të rekomanduara, rekomandohen metoda të ndryshme të punës: grupe dhe të pavarur; tekst-metodë, punëtori, demonstrim, simulim, debat, diskutime, prezantim, hulumtim.

Aktivitetet e rekomanduara kërkojnë nivel të ndryshëm të angazhimit kognitiv të nxënësve, kujtesë, mirëkuptim, analizë, zbatim dhe mund t'i orientojnë mësimdhënësit drejt organizimit të mësimin përmes përfshirjes aktive të nxënësve dhe zhvillimit të mendimit kritik te ata. Pjesa e analizës që vijon ka të bëjë me metodat dhe teknikat mësimore që nxënësit do të donin të zbatohen gjatë mësimin nga arsimit qytetar⁵, dhe të cilat mësimdhënësit i konsiderojnë të realizueshme në mësimdhënie.

Perceptimet për mësimin dhe mbështetje e nxënies

Perceptimet për realizimin e mësimin janë grupuar në dy fusha tematike: 1. Metoda të realizimit të mësimin dhe 2. Mbështetje e nxënies së nxënësve.

Lidhur me metodat që nxënësit do të donin të zbatohen gjatë mësimin të arsimit qytetar, këto janë para së gjithash metoda në të cilat nxënësit që do të mund të mësojnë nga përvojës, përmes vizitave të institucioneve dhe organizatave (42 %), përmes shikimit të materialeve të regjistruara në TV ose internet dhe diskutimit (41,1 %), në tema të propozuara nga nxënësit (36,6 %). Më së paku do të donim të zbatohet ajo që shpesh zbatohet në orë, e ajo është nxënësit të përgatisin dhe ligjërojë disa leksione (22,5 %).

Mësimdhënësit bënin vlerësimin e nivelit të zbatueshmërisë së metodave të përmendura

në programin mësimor për arritjen e qëllimeve nga arsimit qytetar. Sipas tyre, metoda shumë e zbatueshme është: metoda e diskutimit në tema të propozuara nga nxënësit (43,4 %); nxënësit të punojnë në grupe të vogla ose në çifte (39,6 %) dhe shikim i materialeve të regjistruara në TV ose internet dhe diskutim (34 %).

Nëse krahasohen përgjigjet që janë marrë nga nxënësitme përgjigjet e mësimdhënësve (Tablela nr.18) mund të vërehen tri pika kritike në të cilat duhet punuar në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimin në lëndën e arsimit qytetar. **Së pari**, nxënësit do të donin shumë të vizitojnë institucione, organizata, në mënyrë që atë që e mësojnë dhe nga përvoja të mund ta vërtetojnë (e shprehur në diskutimet e grupeve të fokusit), por për mësimdhënësit kjo metodë është thuajse e përzemësueshme. **Së dyti**, nxënësit duan të hulumtojnë, si gjatë orëve, ashtu edhe jashtë orëve, por edhe kjo metodë është thuajse e përzemësueshme për mësimdhënësit dhe së treti, ajo që është shumë e rëndësishme për programin e ri mësimor modular, nxitja e pjesëmarrjes aktive të nxënësve për ndërmarrjen e nismave është e pëlqyeshme nga nxënësit, por jo edhe e realizueshme nga mësimdhënësit. Në përgjithësi, mësimdhënësit kanë rezerva për ato metoda që nënkuptojnë dalje jashtë klasës dhe praktikim të sjelljes qytetare në bashkësi dhe kanë tendencë që t'u përmbahen mënyrave tradicionale të realizimit të mësimin në arsimit qytetar, me fokus në metodat që kërkojnë bashkëpunim, diskutim, analizë të rasteve, etj.

⁵ Shqyrtoheshin metodat e dëshiruara të mësimin, meqë pjesa më e madhe e nxënësve – të anketuar nuk kanë Arsimit qytetar në vitin e parë.

Tabela nr.18 Paraqitje e metodave që nxënësit do të donin të zbatohen gjatë mësimit të arsimit qytetar, mësimeve të kanë vlerësuar nga aspekti i realizueshmërisë së tyre

Kategori të përgjigjeve	Metoda mësimore (%)	
	Nxënës Do të doja shumë	Mësimeve Shumë e realizueshme
Nxënësit vizitojnë institucione, organizata	42.0	7.9
Shikim i materialeve të regjistruara në TV ose internet dhe diskutim	41.1	34
Diskutohet në tema të propozuara nga nxënësit	36.6	43.4
Nxënësit përfshihen në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë (për shembull, aksione ekologjike, aksione humanitare, diskutime për çështje që janë në interes për të rinjtë, etj.)	35.9	33
Realizim i hulumtimeve gjatë orëve	34.4	15.1
Gjenden zgjidhje për situata reale problematike që ndodhin në rrethinë	34.2	33
Simulim i situatave reale	33.3	26.4
Mësimeve ligjëron, nxënësit dëgjojnë	32.6	19.8
Realizim i hulumtimeve jashtë shkollës	32.5	6.6
Nxënësit punojnë në grupe të vogla ose në çifte	31.9	39.6
Veprohet sipas nismës (aktivitet për përmirësimin e bashkësisë) së propozuar nga nxënësit	29.6	15.1
Nxënësit përpilojnë: skema, harta mendore, grumbull, asht peshku, diamant, etj.	24.4	23.6
Nxënësit përgatisin dhe ligjërojnë disa leksione	22.5	25.5
Tjetër*	1,7	3,2

*Tjetër (nxënës): Prezantime në projektor ose TV; Profesorët të lënë më shumë kohë nga fundi i orëve për debatim dhe ngjashëm; Relaksim; Orët të mbahen me më shumë punë praktike për komunikim më të madh dhe mësimin më të shpejtë dhe më të mirë të leksioneve.

*Tjetër (mësimeve): Organizim i debateve dhe metoda – dramatizim, si metodë interaktive për punë në grupe; Lexim dhe punë me tekst, në mënyrë individuale (vetëvlerësim dhe përgjigje)

Në diskutimet e grupeve të fokusit mësimeve u është parashtruar pyetja: **Sa kenë mundësi, gjatë orëve të mësimit, t'i sqaroni nxënësve të gjitha pyetjet dhe nocionet që kanë të bëjnë me ligjërimin ? Përmes cilave metoda dhe teknika e bëni këtë?**

Mësimeve, pa dallim se sipas cilit program punojnë, theksuan se në orë përdorin metoda dhe teknika bashkëkohore interaktive dhe konsiderojnë se mësimi i lëndës arsimit qytetar as që mund të realizohet ndryshe. Metodat që përdoren në të shumtën e rasteve janë: stuhi e ideve, punë në grupe, luajtje e roleve, simulim i zgjedhjeve, debate, kuize, sociodramë, zgjidhje të problemeve, hulumtim, etj.

Nxënësit të cilët punojnë sipas programit të ri konfirmojnë se në orë punohet në mënyra të ndryshme, në grupe, aktivitete të projektit, diskutime, prezantime, etj. Por, ajo që ata do të donin të përforcohet është që të dëgjohet më shumë zëri i tyre gjatë orëve dhe të mësojnë nga përvoja:

„Do të donim të propozojmë vetë, të zgjedhim temë dhe të flasim në mënyrë të relaksuar për këtë.“

„Për shembull, do të ishte mirë të kemi aktrim në orë. Më interesant do të jetë mësimi dhe do të njoftohen se si ne e paramendojmë këtë...“

„Duhet të ketë një lloj të mësimi praktik, gjegjësisht të shijohet ajo që duhet të dihet për në të ardhmen, gjegjësisht realiteti, në jetë. Një lloj debatesh, diskutimesh, diçka... Vetëm jo leksione dhe definicione.“

„Do të doja të punojmë në grupe, është shumë mirë kur i shprehim mendimet tona lidhur me tema të ndryshme. Njëjtë siç flasim më lirshëm këtu (sh.a. në grupin e fokusit) do të mund të flitnim edhe gjatë orëve.“

Mbështetje e nxënies

Mësimi bashkëkohor parashikon që gjatë orës të ndodhë pjesa më e madhe e nxënies, veçanërisht në lëndët siç është arsimit qytetar, te i cili qëllimet në masë të madhe kanë të bëjnë me formimin e qëndrimeve dhe ndërtimin e sistemit të vlerave. Prandaj, një numër i madh i pyetjeve ka të bëjë me mbështetjen e nxënies.

Sqarim i kuptimeve që mësohen

Në programin e arsimit qytetar për vitin e parë të dizajnuar në mënyrë modulare janë përmendur gjithsej 82 nocione që nxënësit duhet t'i përvetësojnë. Me numrin më të madh prej tyre nxënësit me siguri janë takuar edhe në arsimin fillor. Këto në të shumtën e rasteve nuk janë nocione të thjeshta që kuptohen dhe përkufizohen lehtë. Si rezultat, është me rëndësi që gjatë orëve mësimdhënësi t'u ndihmojë nxënësve që t'i kuptojnë saktësisht të gjitha ose shumicën e nocioneve që hasen në ndonjë temë.

Në diskutimet në grupet e fokusit nxënësit janë pyetur: **Sa i sqaron mirë mësimdhënësi/ja derisa ligjëron të gjitha pyetjet dhe nocionet lidhur me përmbajtjen e ligjëratës dhe a parashtroni pyetje nëse diçka keni të paqartë?** Sipas nxënësve, mësimdhënësit sqarojnë aq sa u lejon koha, meqë duhet të diktojnë, nuk ka libër shkollor për këtë program, nuk ka mjete konkretizimi, etj.

„Profesori sqaron me dhënien e dhembujve, kështu kuptojmë më lehtë.“

„Mësimdhënësi sqaron, por për disa raste na thotë: po të ishit viti i katërt do t'ju sqarojë më ndryshe.“

„Ndonjëherë profesoresha na tregon informacione plotësuese në temën nëse ka

informacione, por jo gjithmonë di të na përgjigjet në pyetjet tona dhe do të na thotë që të hulumtojmë vetë.“

„Pyesim lirshëm, por përgjigjet që i marrim janë sikur definicione.“

Pjesa më e madhe e nxënësve pjesëmarrës në diskutimet në grupet e fokusit kanë theksuar se ndjehen të lirë që t'i shprehin mendimet dhe idetë e tyre gjatë orës pa pasur frikë se do të jenë të kritikuar nga bashkënxënësit ose mësimdhënësi. Por, megjithatë, një pjesë e nxënësve kanë ndier se kjo përvojë e parë me realizimin e arsimit qytetar në vitin e parë është sfidë edhe për një pjesë të mësimdhënësve (një pjesë e mësimdhënësve nuk kanë arritur ta përshtatin qasjen e nxënësve nga viti i parë): Me profesorin nuk ndjehemi shumë të lirë, e mes vete jemi të lirë. Me profesorin nuk mund të jemi shumë të lirë meqë vazhdimisht na thotë se nëse do të ishim më të moshuar do të na sqaronte më ndryshe.

Pjesëmarrje aktive e nxënësve

Në mësimin në të gjitha lëndët pritet që nxënësit të mund të marrin pjesë aktive në aktivitetet e orës dhe të mund të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre. Në lëndën e arsimit qytetar pritet që kjo të jetë praktikë e rregullt në mësim, duke marrë parasysh faktin se nxënësit duhet të mësojnë jo vetëm përmes teorisë, por edhe përmes pjesëmarrjes dhe praktikimit aktiv të shprehjes së lirë dhe vendimmarrjes, pa qenë të kritikuar për atë. Mësimdhënësit konsiderojnë se nxënësit ndjehen të lirë për të shprehur mendimin personal gjatë orëve.

Por, nga përgjigjet e nxënësve në pyetjen: **Sa ju nxitë mësimdhënësi/ja që të merrni pjesë aktive në orë? (për shembull të diskutoni, të bëni hulumtim, projekte, të aktroni situata, etj.)** në diskutimet e grupeve të fokusit një numër shumë i vogël i nxënësve kanë theksuar se janë të nxitur në pjesëmarrje aktive gjatë orëve.

„Profesoresha në të shumtën e rasteve jep argumente që bien ndesh me tonat për të parë se si do të reagojmë, për të parë këndvështrimin tonë për situatën.“

„Profesoresha na pyet për mendimin tonë dhe i pranon informatat tona. Më pas diçka shton ose heqë, përmirëson nëse diçka është gabim.“

„Nëse na është interesante tema të gjithë jemi aktivë dhe nuk ka nevojë për të na nxitur.“

„Pjesa më e madhe e nxënësve kanë pasur përvojë të kundërt.“

„Na nxisin shumë dobët për të shkëmbyer mendimin tonë. Kjo ndodh për shkak të faktit se në pjesën më të madhe të orëve vetëm rrimë dhe mërzhitemi derisa ligjëron profesoresha, ndërsa ne shkruajmë në fletore dhe nuk ka kohë për zhvillimin e diskutimit.“

„Na nxitë shumë dobët për të shprehur mendimin tonë. Në të shumtën e rasteve orët janë të njëanshme, profesoresha do të ligjërojë gjithçka dhe nuk kemi kohë për zhvillimin e diskutimit.“

„Deri tani në klasën tonë kemi pasur vetëm dy herë ushtrime interesante, por megjithatë kjo nuk është diçka shumë specifike dhe interesante.“

Mund të konstatohet se ndonëse programi nënkupton pjesëmarrje aktive të nxënësve dhe praktikim të sjelljes demokratike gjatë orëve, jo të gjithë mësimitdhënësit i praktikojnë këto parime në praktikë.

4.3 Notim i të arriturave nga arsimit qytetar

Në programin e dizajnuar në mënyrë modulare të arsimit qytetar ka udhëzime për notimin e të arriturave të nxënësve, gjegjësisht është përmendur si vijon:

Të arriturat e nxënësve gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen duke përdorur kriteret për notim që, në fakt, në programin mësimit janë paraqitur si standarde për të arritura në raport me secilin rezultat nga nxënia dhe përshkruajnë se çfarë pritet nga nxënësi që të bëjë për të treguar se është arritur rezultati nga nxënia. Gjatë mësimit ndiqen aktivitetet për nxënie, motivimi për nxënie, bashkëpunimi me të tjerët, raporti kritik ndaj asaj që është mësuar dhe raporti krijues ndaj asaj që është mësuar, gjegjësisht ndërtimi i qëndrimeve dhe mendimeve të tyre për çështje të caktuara nga materiali mësimit. Këto njohuri përdoren për mbështetjen e nxënësve në nxënie. Me këtë rast, përdoren strategji dhe teknika të ndryshme për notimin formativ, duke përfshirë edhe vetënotimin dhe notimin e ndërsjellë.

Bazë e vlerësimit sumativ janë kriteret për notim që duhet të konjektizohen në mënyrë plotësuese në nivel të shkollës ose në nivel të bashkësive të shkollave/bashkësive. Vlerësimet sumative përcaktohen në bazë të përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të notimit të harmonizuara me kriteret për notim (pyetje të eseve, teste, prezantime me gojë, projekte...) Në notim nuk ndikojnë qëndrimet e nxënësve për çështje të caktuara shoqërore, por vlerësohet aftësia për analizë, interpretim dhe vlerësim.

Secili nxënës është i informuar rregullisht për të arriturat e tij, e gjithashtu informohen edhe prindërit për të arriturat e nxënësit. Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimitdhënësit për mësimin dhe nxënien.

Në programet mësimore: **Arsimi qytetar për vitin e katër për profesionin ekonomik, juridik dhe tregtar në arsimin e mesëm profesional dhe Arsimit qytetar për vitin e katërt për të gjitha profilet për arsim profesional përveç profesionit ekonomik, juridik dhe tregtar** përmendet si vijon:

Shqyrtimi i përparimit të diturive dhe aftësive të nxënësve duhet të jetë i planifikuar, sistematik dhe permanent. I njëjti duhet të bëhet në mënyrë të ndryshme (me gojë dhe me shkrim) me instrumente të përpiluara me dedikim (teste të diturive dhe pyetësorë). Për të arriturat e nxënësve mësimitdhënësi duhet të përpilojë standarde, që duhet t'i dinë nxënësit, e edhe prindërit e tyre. Me qasjen e këtillë në notim do të zhvillohet edhe ndjenja e autokritikës në notimin e diturive të tyre.

Në programin për aktivitetet të projektit për kulturë qytetare bëhet e ditur:

Nënshkrimi i mësimitdhënësit (mentorit që e ndjekë punën e nxënësve) është dëshmi për detyrën e kryer mirë, që duhet të qëndrojë në fletën evidentuese që e plotëson nxënësi pas çdo aktiviteti të përfunduar.

Të dhënat që janë marrë nga anketimi tregojnë se përgjigjet e nxënësve (40 %) dhe mësimitdhënëseve (47,2 %) në raport me notimin përputhen, gjegjësisht konsiderojnë se notimi duhet të jetë numerik nga një deri pesë. Pjesa më e madhe e nxënësve (39,2 %) duan që mësimitdhënësi gojarisht t'u tregojë se sa kanë arritur dhe t'u japë udhëzime për përmirësim, pjesa më e vogël e nxënësve janë shprehur për informata kthyesë me shkrim (19,1 %), notim të moshatarëve (17,2 %) dhe notim të mëvetësishëm (16,6 %). 15,4 % e nxënësve janë përgjigjur se nuk ka nevojë për notim në orët e arsimit qytetar (nxënësit kanë mundësi të zgjedhin më shumë përgjigje të pyetjes së parashtruar).



Edhe një përqindje e vogël e mësimitdhënësve (5,7 %) janë përgjigjur se nuk ka nevojë që nxënësit të notohen. Në raport me mundësinë për notim përshkrues të nxënësve, mësimitdhënësit janë të ndarë, 13,2 % konsiderojnë se notimi duhet të jetë vetëm përshkrues, duke përfshirë sjelljen dhe aktivitetin në orë, derisa 13,2 % e mësimitdhënësve konsiderojnë se notimi duhet të jetë i kombinuar, duke përfshirë mënyrën numerike edhe atë përshkruese (kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 21,7 % e mësimitdhënësve).

Në diskutimet grupore të fokusit me nxënësit, ata në bazë të përvojave të tyre nga realizimi i programit modular konsiderojnë se për lëndën nuk është e domosdoshme mënyra klasike të vlerësimit përmes testeve ose ngjashëm.

„Nuk duhet të ketë teste ose diçka të tillë në këtë lëndë, për këtë lëndë nevojitet diskutim. Pra të notohet sipas diskutimeve, e jo sipas hartimit të planeve.“

Mësimitdhënësit të cilët u anketuan bënë vlerësimin në raport me kohën dhe mundësitë për të përdorur mënyra të ndryshme të notimit të të arriturave. Sipas përgjigjeve, mund të përcaktohet se mësimitdhënësit kanë kohë dhe mundësi për dhënien e informatave kthyesë me gojë dhe udhëzime për përmirësim, që është informatë mjaft pozitive duke marrë parasysh njohuritë se informata kthyesë cilësor dhe me kohë është mënyra më e mirë për mbështetjen e nxënies. Megjithatë, kanë më pak kohë, mundësi, po ndoshta edhe njohuri të pamjaftueshme të metodave për notim të mëvetësishëm dhe moshatar. (Tabela 19)

Tabela nr. 19 Vlerësim i mundësive për përdorimin e mënyrave të ndryshme të notimit

Kategori të përgjigjeve	Në masë të madhe	Deri diku	Në masë të vogël	Thujse nuk mundem	Nuk janë përgjigjur
Nxënësve t'u jepni informacion kthyes me goj dhe udhëzime për përmirësim	51.9	19.8	2.8	2.8	22.6
Nxënësve t'u jepni informacion kthyes me shkrim dhe udhëzime për përmirësim	28.3	29.2	15.1	4.7	22.6
Secili nxënës të notohet mëvetësisht, në bazë të kriterëve të caktuara	26.4	29.2	16.0	3.8	24.5
Nxënësit të notohen mes vete në bazë të kriterëve të caktuara	20.8	36.8	18.9	0.9	22.6

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve = 106).

4.4 Shqyrtim i materialeve për nxënie

Lidhur me atë se cilat materiale mund të përdoren për mësimdhënien e përmbajtjeve të arsimit qytetar, nxënësit në vend të parë e kanë veçuar librin shkollor (45,3 %), më pas videot/filmat (40,7 %), përmbajtjet nga interneti (gazeta/revista, enciklopedi, libra) (28%). Nxënësit, siç duket, nuk janë të mësuar të kombinojnë lloje të ndryshme të materialeve gjatë mësimit dhe kanë tendencë të orientohen drejt materialeve që përdoren tradicionalisht në mësim.

Tabela nr.20 Si mendojnë nxënësit lidhur me atë se prej çfarë materialesh do të donin të mësojnë arsimin qytetar

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
libër shkollor	332	45.3
video/filma	298	40.7
përmbajtje nga interneti (gazeta/revista, enciklopedi, libra)	205	28.0
fleta pune	147	20.1
hulumtim i literatures së përmendur (gazeta/revista, enciklopedi)	118	16.1

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve = 733)

Duke marrë parasysh këtë, mungesa e librit shkollor për programin e ri modular paraqet sfidë serioze për nxënësit. Në diskutimet në grupet e fokusit nxënësit që mësojnë arsim qytetar sipas programit modular theksuan se mungesa e librit shkollor ua vështirëson mësimin dhe nxënien.

„Nuk kemi libër shkollor dhe kështu është vështirë, më e mundimshme. Duam të përdorim video, fotografi, është më interesant kur shikon edhe koncentrohesh më lehtë.“

„Të kemi libër shkollor, meqë me shkrimin merret shumë kohë nga ora, nuk mbetet kohë për diskutime.“

„Ndonjëherë profesoresha fotografon nga libri leksionet dhe na i dërgon.“

„Pra, prej materialeve kemi vetëm diktat nga profesoresha të pjesëve më të rëndësishme, nxënie e thatë që nuk na motivon.“

Nxënësit i theksojnë edhe karakteristikat që do të duhej t'i ketë libri shkollor (pyetje, detyra), si dhe materialet tjera prej të cilave do të donin të mësojnë.

„Në librin shkollor duhet të ketë pyetje, detyra për hulumtim, e jo tekste shumë të gjata.“

„Të ketë më shumë filma ose diçka që mund ta shikojmë, meqë kështu do të kuptojmë më mirë. Sado që të lexojmë, nuk do të kuptojmë më shumë nëse këtë nuk e pranojmë në mënyrë vizuale.“

Edhe për mësimdhënësit, libri shkollor është resursi numër një për realizimin e suksesshëm të mësimin nga arsimit qytetar (59,4 %), më pas vijnë resurset on-lajn (55,7 %), doracakët për mësimdhënësit (50 %).

Tabela nr. 21 Resurse të nevojshme për realizim të suksesshëm të mësimin në lëndën e arsimit qytetar /kultura qytetare

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
libër shkollor	63	59.4
resurse on-lajn	59	55.7
doracak për mësimdhënësit	53	50.0
fleta pune	53	50.0
literaturë plotësuese për përmbajtjet mësimore	47	44.3
instrumente për ndjekjen e përparimit të nxënësit	41	38.7
trajtime on-lajn	35	33.0
bashkësi për nxënie/zhvillim profesional	25	23.6
tjetër (përmendni)*	6	5.7

(Për qindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve =106)

*Tjetër: Të kemi mundësi për mësim praktik, gjegjësisht vizitë të institucioneve, monumenteve kulturore, debate me autoritetet komunale, simulime të këshillit të komunës, etj.; TV, projektor LCD; Trajtime përkatëse; Klasë të specializuar me infrastrukturë të duhur shkollore sipas standardeve për hapësirë dhe pajisje të përcaktuara në programin mësimor të lëndës të vitit 2002 të plotësuar me kompjuterë, printer dhe projektor.

Mësimdhënësit-pjesëmarrës në grupet e fokusit bëjnë të ditur për një pjesë të problemeve me materialet mësimore, si mungesë e librit shkollor për nevojat e programit modular, vjetërim të përmbajtjeve në librat shkollor që përdoren në vitin e katërt, mungesë të doracakëve për mësim, etj.

„Nevojiten filma dokumentar, të rinjtë duan të mësojnë më shumë në mënyrë vizuale.“

„Na nevojitet më shumë mbështetje praktike, sesa teorike.“

„Në librat aktual ka mungesa serioze veçanërisht gjatë përkthimit në gjuhën shqipe.“

Nga përgjigjet e mësimdhënëseve në diskutimet e grupeve të fokusit mund të konstatohet se në orë përdoren: përmbajtje digjitale, më pas gazeta / revista, fotografi,

vizatime, videomateriale/audiomateriale dhe libra të tjerë. Përgjigjet e nxënësve bëjnë të ditur në atë se burimet plotësuese të nxënies u nevojiten për të kuptuar më mirë përmbajtjet, ndërsa si më të dobishme i përmendin përmbajtjet digjitale, librat tjerë, gazetat / revistat, fotografitë / vizatimet, videomaterialet dhe audiomaterialet. Në përgjithësi, përgjigjet e mësimit dhe nxënësve janë kompatible, por bëjnë të ditur në faktin se mësimit do të mund të përdornin më shumë literaturë plotësuese gjatë mësimit, meqë nxënësit e konsiderojnë të dobishme.

Veçanërisht theksohet nevoja për doracakë për realizimin e qëllimeve individuale nga programi, ku ato arrihen përmes metodave bashkëkohore interaktive mësimore. Sipas fjalëve të një pjese të mësimit dhe nxënësve, doracakët e këtillë janë shumë të dobishëm dhe praktik meqë ofrojnë modele konkrete të përpunimit të njësive individuale mësimore.

4.5 Pikëveshtrime të mësimit për zhvillimin profesional

Duke marrë parasysh se mësimit e arsimit qytetar, gjatë viteve të kaluara nuk kanë pasur trajnime formale për lëndën e tyre mësimore, ishte me rëndësi që të shqyrtohet se në çfarë mënyre ata janë sendërtuar në aspektin profesional për zbatimin e mësimit. Përgjigjet e mësimit në pyetjen: **Gjatë 3 viteve të kaluara a keni marrë pjesë në ndonjë trajnim, lidhur me punën Tuaj?** Janë paraqitur në tabelën 22 më poshtë.

Tabela nr. 22 Numri i mësimit të cilët kanë marrë pjesë në trajnime gjatë 3 viteve të kaluara

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Po	47	44.3
Jo	58	54.7
Nuk janë përgjigjur	1	.9
Gjithsej	106	100

Të dhënat bëjnë të ditur për pjesëmarrjen e pamjaftueshme në trajnime profesionale të më shumë se gjysma e mësimit dhe nxënësve, gjë që paraqet një të dhënë brengosëse. Ata të cilët kanë marrë pjesë në trajnime, në të shumtën e rasteve kanë ndjekur trajnime për metoda aktive të nxënies dhe mësimit dhe krijimit të shkollave inovative (Tabela nr. 23).



Tabela nr. 23 Paraqitje e temave të ndjekura në trajnimet (gjatë 3 viteve të kaluara)

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Metoda aktive të nxënies dhe mësimdhënies	12	16.2
Mësim dhe nxënie në shekullin 21, krijim i shkollave inovative: Përgatitje të nxënësve për shekullin 21	10	13.5
Sendërtim i kapaciteteve qytetare, socio-politike dhe demokratike të mësimdhënësve të shkollave të mesme nga lënda e sociologjisë dhe arsimit qytetar dhe nxënësve të tyre	6	8.1
Integrim ndëretnik në arsimin	4	5.4
Koncept i ri mësimor për arsim qytetar për klasën e VIII-të	3	4.1
BE për mësimdhënës	3	4.1
Demokracia dhe Kuvendi	3	4.1
Trajnim për zbatimin e pakos së resurseve për pjesëmarrje të nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	2	2.7
Profil i mësimdhënësit modern	2	2.7
Trajnim themelor për forcimin e kapaciteteve të mësimdhënësve, nëpunësve komunalë dhe prindërve për parandalimin e radikalizmit që shpie drejt dhunës	2	2.7
Zbatim i programit modular të arsimit qytetar për vitin e parë	2	2.7
Komunikim efikas	2	2.7
Përpilim dhe zbatim të Padlet, QR, Giphy	2	2.7
Ndjekje formative e të arriturve të nxënësve	2	2.7
Përdorim i filmave kreativ dokumentar në mësim (Makedoks)	2	2.7
Demokracia dhe të drejtat e njeriut	1	1.4
Kohezioni social	1	1.4
Debat për vendin e sociologjisë në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë – zhvillimet me arsimin qytetar dhe tërheqja e librave shkollorë në arsimin e mesëm dhe të lartë si shkas	1	1.4
Shkathësi për punësim	1	1.4
Debat në mësim	1	1.4
Metoda dhe teknika të hulumtimit të individit dhe shoqërisë	1	1.4
Metoda joformale për punë me të rinj	1	1.4
Komponente profesionale te drejtorët, bashkëpunëtorët profesional dhe mësimdhënësit	1	1.4
Zgjidhje e konflikteve	1	1.4
Udhëzime për përpilimin e detyrës së projektit në kuadër të maturës shtetërore	1	1.4
Të drejtat e njeriut	1	1.4
Punë rinore	1	1.4
Për individin dhe identitetin e tij	1	1.4
Arsim inkluziv	1	1.4
E drejta për shkollë të ndjeshme dhe të sigurt gjinore	1	1.4
Këshillim për karrierë	1	1.4
Projekti "Shkëmbim interkulturore mes nxënësve nga Maqedonia dhe Moldavia "- punëtori për identitetin dhe zhvillimin personal, komunikimin interkulturore dhe të drejtat e fëmijëve	1	1.4
Gjithsej përgjigje	74	100

Pyetësi ofronte opsionin një mësimdhënës të cekë më së shumti tri trajnime

Sipas të dhënave që janë marrë, trajnimet në të shumtën e rasteve do të ishin realizuar ballë për ballë, gjegjësisht në formë të seminarit, punëtorisë ose ligjërat në kohëzgjatje prej një deri dy ditë.

Mësimdhënësit i vlerësojnë trajnimet e ndjekura si të dobishme, nga aspekti i asaj se gjatë trajnimeve ka pasur shkëmbim të përvojave/praktikave të mira, gjegjësisht mënyrë interaktive të punës dhe janë përpunuar përmbajtje relevante (Tabela nr. 24).

Tabela nr. 24 Çfarë u ka pëlqyer mësimdhënësve në trajnimet në të cilat kanë marrë pjesë në 3 vitet e kaluar

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Shkëmbim i përvojave/praktikave të mira	30	28.3
Përmbajtje të dobishme/relevant e	22	20.8
Mënyrë interaktive e punës	22	20.8
Ligjërues profesional/moderator-trajnues	16	15.1
Shoqërim me kolegët	12	11.3

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve = 106)

Ajo që mësimdhënësit e presin në trajnimet është që të jepen më shumë shembuj dhe të ketë më shumë trajnime/aktivitete.

Tabela nr. 25 Çfarë do të kishit ndryshuar në trajnimet në të cilat keni marrë pjesë deri tani (në 3 vitet e kaluara)

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
Të jepen më shumë shembuj	26	24.5
Të kemi më shumë trajnime /aktivitete	18	17.0
Përmbajtja të jetë më adekuate	11	10.4
Organizimi të jetë më i mirë	11	10.4
Ligjëruesit/trajnuesit të jenë profesional	6	5.7
Tjetër (plotësoni)*	1	0.9

(Përqindja e përgjigjeve në çdo kategori të përgjigjeve është përlogaritur nga numri i përgjithshëm i të anketuarve = 106)

Më konkretisht, në diskutimet në grupet e fokusit mësimdhënësit theksuan se duan trajnime më të shpeshta, më afatgjate, interdisciplinare, të mbështetura në empirikë dhe të përcjella me doracak për mësimdhënës. Ata theksojnë se krahas trajnimeve që kanë të bëjnë me aspektet e


përmbajtjeve të programit nevojiten edhe trajnime për metoda dhe teknika bashkëkohore të mësim, por jo të përgjithshme dhe parciale, por rrënjësore.

„Nevojiten trajnime për metoda, teknika dhe mënyra të realizimit të mësim, por jo lloje të tilla të trajnimeve që i organizon Byroja për Zhvillimin e Arsimit përmes akreditimit të metodave dhe teknikave bashkëkohore. Trajnimet e tilla janë të panevojshme, meqë janë shumë të përgjithësuara, në nivel të ulët dhe të thata. Nevojiten trajnime më mirë të përgatitura, koncize, përmbajtësore.“

„Nevojiten trajnime më të shpeshta, ndërsa do të ishte mirë të ketë doracak për mësimdhënës me metoda dhe aktivitete konkrete të përpunuara.“

„Trajnimi për programin modular zgjati një ditë dhe nuk ishte i mjaftueshëm për mbështetjen e mësimdhënësve për planifikimin dhe realizimin e programit.“

„Duhet të ketë trajnime më të shpeshta meqë lënda thithë njohuri prej më shumë shkencave, historiani realizon mësim nga aspekti historik, sociologu nga aspekti sociologjik dhe në këtë mënyrë krijohen diskrepanca. Duhet të ketë trajnime për të gjitha temat (njësi modulare) dhe gjithsesi nuk janë të tepërta trajnimet për metoda dhe teknika interaktive.“



5. SHQYRTIM PËRMBLEDHËS I KONSTATIMEVE NGA HULUMTIMI

GJYKIME PËR PROGRAMET MËSIMORE NGA LËNDA E ARSIMIT QYTETAR

Sipas nxënësve, lënda arsim qytetar është shumë e dobishme për jetën e tyre të përditshme. Gjysma e nxënësve të anketuar konsiderojnë se në arsimin e mesëm duhet të mësohen përmbajtje nga arsimit qytetar, derisa 26,5% e nxënësve konsiderojnë se duhet të mësohet si lëndë e veçantë mësimore. Përqindja e këtyre ka të bëjë me vlerësimet pozitive nga nxënësit që kanë punuar sipas programit modular, si dhe me vlerësimet pozitive nga nxënësit e shkollave të mesme profesionale, derisa vetëm një e pesta e nxënësve në paralelet e gjimnazit e preferojnë këtë formë të mësimdhënies së arsimit qytetar.

Lidhur me atë se çfarë duhet të mësohet nga arsimit qytetar nxënësit në vend të parë i kanë veçuar njohuritë për “të drejtat dhe mbrojtjen e tyre” (53,3 %), ndërsa në vendin e fundit shkathtësitë “si të mendojmë dhe nxjerrim konstatime” (18 %). Nxënësit, në pjesën më të madhe, nuk e vërejnë zbatimin praktik të lëndës për zhvillimin e shkathtësive, vlerave dhe sjelljeve. Perceptimi i lëndës është kryesisht si mekanizëm për përvetësimin e diturive. Ky konstatim më shumë ka të bëjë me nxënësit në paralelet e gjimnazit, krahasuar me nxënësit që kanë punuar sipas programit të dizajnuar modular.

Nga ana tjetër, ata duan të mësojnë përmbajtje që nënkuptojnë përvetësimin e shkathtësive praktike për jetesë. Nxënësit kanë theksuar se më së shumti do të kishin dashur të mësojnë për humanitet, jetesë të shëndoshë dhe komunikim, ndërsa më së paku për atë se si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri.

Mësimdhënësit, si edhe nxënësit, konsiderojnë se mënyra e mësimdhënies së arsimit qytetar duhet të jetë përmes lëndës së veçantë mësimore në të gjitha shkollat e mesme (63,2 %). Sipas tyre, arsimit qytetar është i nevojshëm për nxënësit që të mësojnë se si të përfshihen në përmirësimin e bashkësisë (70,8 %), si dhe për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen e tyre (67 %).

Mësimdhënësit kanë nevojë për mbështetje në realizimin e përmbajtjeve: Pushteti në funksion të qytetarëve; Roli shoqëror i shtetit dhe administratës publike; Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm; Organizata qytetare dhe grupe të përfaqësimit; Përballje me konflikt; Kontroll i sjelljes; Qytetari si konsumator dhe kursimtar; gjë që është e pritshme duke marrë parasysh faktin se ato në pjesën më të madhe janë risi në këtë lëndë.

Në mënyrë plotësuese, mësimdhënësit propozojnë që në programin mësimor për arsim qytetar të përfshihen edhe temat vijuese: Lëvizje shoqërore; Histori e sistemeve shoqërore; Veprim kolektiv. Këto janë tema të rëndësishme, sipas mësimdhënësve, për t'u kuptuar proceset në arsimin qytetar.

METODA PËR REALIZIMIN E MËSIMDHËNIES DHE MBËSHTETJE TË NXËNIES

Sipas përgjigjeve të nxënësve, mësimdhënësit i përdorin metodat aktive të nxënies, por meqë për programin e ri modular të arsimit qytetar nuk ka libër shkollor, as doracak për nxënësit, mësimdhënësit kanë tendencë të diktojnë atë që është më e rëndësishme, planin e orës dhe definicionet.

Kur i kanë vlerësuar metodat e nxënies që më së shumti i preferojnë, nxënësit i kanë radhitur më së miri ato që dëshirojnë t'i kenë gjatë orëve: Vizitë në institucione, organizata, shikim i materialeve të regjistruara, videove në TV ose internet; dhe Diskutim në tema të propozuara nga nxënësit, derisa metoda më së paku e dëshiruar për ta është kur do të marrin detyrë të përgatisin dhe të ligjërojnë leksion në orë.

Sipas mësimdhënësve, Diskutimi në tema të propozuara nga nxënësit - është metodë që është më së shumti e realizueshme për orët e arsimit qytetar, pas çka vijon puna në grupe të vogla ose çifte, më pas shikimi i materialeve të regjistruara dhe diskutimi. Si më së paku të zbatueshme mësimdhënësit i kanë veçuar metodat që nxënësit i dëshirojnë dhe të cilat nënkuptojnë aktivitete jashtë klase: vizitë në institucione dhe organizata, si dhe metodat e angazhimit të nxënësve në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë.

Të ndryshme janë perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me atë nëse çdoherë mund të shprehin lirshëm mendimin pa qenë të kritikuar. Mësimdhënësit konsiderojnë se nxënësit janë të lirë, por nxënësit nuk kanë ndjenjë të tillë, meqë sipas tyre, gjatë orëve nuk ka gjithmonë kohë për diskutime. Si rezultat i kësaj, numri më i madh i nxënësve nuk kanë ndjenjë se mësimdhënësit i nxisin drejt pjesëmarrjes

aktive, ndërsa të tjerët mendojnë se kjo ndodhë ndonjëherë.

GJYKIME PËR LIBRAT SHKOLLORË DHE MATERIALET / RESURSET PLOTËSUESE

Meqë për programin e ri modular nuk ka libër shkollor, as doracak për mësimdhënësit, mësimdhënësit kanë tendencë të gjejnë dhe kombinojnë materiale në mënyrë të mëvetësishme (nga doracakët për Shkathtësi jetësore; Udhëzuesi për nxënës për arsim qytetar për klasën e tetë; libra të vjetër shkollor për arsim qytetar, e të tjerë) dhe t'i diktojnë gjërat themelore që duhet t'i memorizojnë nxënësit. Nxënësit konsiderojnë se nëse do të kishin libër shkollor orët do të bëheshin më interesante, do të lirohej kohë për diskutime, hulumtime, gjegjësisht nuk do të humbet kohë në diktim. Krahas librit shkollor, nxënësit do të donin që arsimin qytetar ta mësojnë prej videove/filmave, përmbajtjeve ngainterneti: gazeta/revista, enciklopedi, libra.

Qëndrimi i mësimdhënësve është se në librin shkollor që është përdorur për realizimin e programit më të vjetër të arsimit qytetar, një pjesë e temave dhe kuptimeve/definicioneve janë të vjetëruara, problematike ose habitëse. Për shkak të kësaj, mësimdhënësit kanë nevojë për materiale plotësuese, duke përfshirë: resurse on-lajn, doracakë për realizimin e përmbajtjeve mësimore me punëtori kreative, video të shkurtra, fleta të punës, literaturë plotësuese, etj.

PJESËMARRJE E NXËNËSVE NË AKTIVITETE PËR PËRMIRËSIMIN E BASHKËSISË

Vetëm një prej pesë nxënësve të anketuar është përgjigjur se ka marrë pjesë në aktivitete për përmirësimin e bashkësisë në të cilën jeton (për shembull, aksione ekologjike, humanitare, artistike), që është njëri prej treguesve për gatishmërinë e tyre në angazhim qytetar.

Mësimdhënësit konsiderojnë se mund të mbështesin "nxënien për arsim qytetar" përmes: nxitjes së nxënësve që të përfshihen në punë në shoqata/organizata të ndryshme, si dhe përmes inkurajimit të nxënësve që të marrin pjesë në punën e bashkësisë së nxënësve.

Megjithatë, sipas nxënësve, shumica e mësimdhënësve nuk i nxisin që t'i kuptojnë problemet me të cilat përballen bashkësia në të cilën mësojnë dhe jetojnë, të mendojnë për zgjidhje të problemeve dhe të përfshihen në aktivitete në bashkësinë lokale, ndonëse te

nxënësit ekziston interes i madh për mënyra të këtylla të angazhimit në bashkësi.

TRAJNIME PËR REALIZIMIN E ARSIMIT QYTETAR

Praktika e deritanishme mësimore, më shumë sesa studimet, i kanë aftësuar mësimdhënësit me njohuri dhe për të kuptuar përmbajtjet nga arsimit qytetar, ndërsa më së paku me njohuri për të gjetur burime/materiale përkatëse për mbështetjen e mësimin dhe nxënies (materiale për mësimdhënësit dhe materiale për nxënësit).

Gjatë tre viteve të shkuara 44 % e mësimdhënësve kanë ndjekur trajnim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte lidhur me lëndën arsim qytetar. Ajo që u ka pëlqyer mësimdhënësve gjatë trajnimeve është shkëmbimi i përvojave/praktikave të mira, ndërsa do të donin që trajnimet të përmbajnë më shumë shembuj, të ketë më shumë trajnime/aktivitete dhe përmbajtja të jetë më adekuate.

Shumica e mësimdhënësve duan trajnime për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe trajnime konkrete për realizimin e përmbajtjeve nga programi mësimor përmes teknikave bashkëkohore mësimore. Në mënyrë plotësuese, mësimdhënësve u nevojiten trajnime për shfrytëzimin e internetit si resurs, trajnime për metoda të notimit dhe rritjen e të arriturave të nxënësve përmes mësimdhënies përkatëse (punëtori kreative), si dhe trajnime profesionale/të specializuara për disa përmbajtje të caktuara mësimore.

6. REKOMANDIME

PROGRAME MËSIMORE

- Qasja e mësimdhënies së arsimit qytetar në shkollat e mesme duhet të rishikohet dhe të harmonizohet me programet në përputhje me dokumentin „Kompetenca qytetare“. Nevojitet që programet në strukturën e saj të përmbajnë:
 - Rezultate nga nxënia që do të mbështeten në kompetencat themelore qytetare (njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera, sjellje qytetare) që duhet t'i zhvillojnë nxënësit;
 - Përmbajtje dhe kuptime që do të duhet t'i miratojnë nxënësit;
 - Aktivitete dhe metoda që do të nxisin pjesëmarrje aktive të nxënësve në procesin e miratimit të kompetencave qytetare;
 - Kriteretë notimit, gjegjësisht standarde/tregues për të arriturat e rezultateve nga nxënia.
- Për realizimin e përmbajtjeve nga programi mësimor që kanë për qëllim të nxisin pjesëmarrje të nxënësve në aktivitete për përmirësimin e bashkësive nevojitet t'u jepet mbështetje shkollave të mesme në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të qasjes gjithpërfshirëse. Nevojitet trajnim dhe mbështetje përkatëse për përfshirjen e të gjitha subjekteve në shkollë (kuadër udhëheqës, shërbim profesional, mësimdhënës, nxënës) në planifikimin dhe realizimin e aksioneve për tema që janë me rëndësi të madhe për bashkësinë, shëndetin, mjedisin jetësor, më pas për tema të ndjeshme siç janë, për shembull, sjelljet e rrezikshme, dhuna dhe, në përgjithësi, temat që kërkojnë marrje të vendimeve për jetën personale, stilin jetësor dhe që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve në bashkësi.
- Fondi i orëve të arrijë 2 orë në javë.

METODA TË REALIZIMIT TË MËSIMDHËNIES

- Duhet të ulet frekuenca e qasjes „ligjëruese-diktuese“ në mësimin dhe të rritet përdorimi i metodave interaktive. I tërë mësimi duhet të demokratizohet edhe më shumë, që nxënësit të mësojnë nga përvoja, gjegjësisht të mësojnë më shumë nga ajo që bëhet, e jo vetëm nga ajo që ligjërohet gjatë orëve.

- Mësimdhënësit të krijojnë kushte në të cilat zëri i nxënësve do të dëgjohej dhe respektohet në klasë. Ky proces mund të stimulohet me zbatimin e metodave të ndryshme, si për shembull: debate për çështje të ndryshme politike, diskutime dhe debate për çështje kontroverze që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, dallime në raport me gjininë, racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen kombëtare ose etnike, pengesë, gjini, orientim seksual, identitet gjinor, prejardhje sociale, arsim, religjion ose bindje fetare; simulime të zgjedhjeve; simulime të fushatës politike; parlament; gjykime; përkufizime dhe përdorim të procedurave të drejta për vendimmarrje mes më shumë opsioneve, të provuarit e roleve të ndryshme përmes lojës dhe simulimit, duke përfshirë eksperimentimin me pozicione të fuqisë (ditë si kryetar i qytetit), e drejta e fjalës së lirë (simulim i punës së gazetarëve).
- Nxënia përmes projekteve është element, metodë e rëndësishme, në realizimin e qëllimeve të arsimit qytetar, meqë mundëson përvetësimin e kompetencave qytetare përmes përdorimit të resurseve të ndryshme dhe mënyrave të ndryshme të grumbullimit, klasifikimit dhe prezantimit të të dhënave, gjegjësisht integrimin e diturive dhe shkathtësive prej fushave, lëndëve të ndryshme. Projektet mund të jenë pjesë e mësimdhënies së përmbajtjeve mësimore, por, gjithashtu, mund të paraqesin mënyrën e përpunimit dhe ndërmarrjes së aksioneve për tema që janë me rëndësi të madhe për shëndetin, mjedisin jetësor, bashkësinë, më pas për tema të ndjeshme siç janë, për shembull, sjelljet e rrezikshme, dhuna dhe në përgjithësi, temat që kërkojnë marrjen e vendimeve për jetën personale, stilin e jetës dhe që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve në bashkësinë.
- Nxënësit duhet të marrin rregullisht informata cilësore kthyes nga mësimdhënësit (që kjo nuk është rast), që do të kontribuojë në nxënien më cilësore.

LIBRA SHKOLLORË, DORACAKË DHE MATERIALE PLOTËSUESE

- Nevojitet të përpilohet një libër shkollor i harmonizuar me programin e ri mësimor, i harmonizuar me nevojat dhe interesat zhvillimore të nxënësve. Gjegjësisht, me më shumë aktivitete që do të nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, reflektim për faktet që mësohen, ndërlikueshmërinë e tyre, lidhshmërinë, mendimin kritik dhe zhvillimin e diturive personale për faktet dhe të dhënat,

vendimmarrje me përgjegjësi dhe ndërmarrjen e aksioneve në kontekst. Pjesëmarrja e këtillë mundëson që të zhvillohen pavarësia dhe autonomia e nxënësve dhe potenciali për t'u përballur me ndikimet komplekse në jetën e tyre dhe më gjerë në botë.

- Nevojitet të përpilohen doracakë për realizimin e mësimit me përdorimin e metodave interaktive, punëtori kreative që do t'u japin ide dhe mbështetje mësimit në planifikimin dhe realizimin e mësimit që do t'i shmangen transmetimit të diturive të gatshme për atë se si do të duhej të veprohet në situata të caktuara, përkundrazi do të përfshijë zhvillimin e kompetencave që do t'u mundësojnë nxënësve të marrin vendime të informuara dhe të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme.
- Nevojitet përfshirje e mediave të ndryshme në mësim (elektronike, të shtypura, etj.), video të shkurtra, filma, përmbajtje nga interneti (gazeta, revista, enciklopedi, libra) me qëllim që u ndihmojnë nxënësve të vijnë deri te informacionet relevante për ngjarjet/zhvillimet vijuese në bashkësi. Materialet plotësuese mund t'i rrisin mundësitë për nxënie, e mbështesin ndërtimin e diturisë, e përmirësojnë kuptimin e materies, mbjellin interes, e rrisin motivimin dhe kontribuojnë për qëndrime pozitive në raport me nxënien.

TRAJNIME DHE MBËSHTETJE PROFESIONALE


- Mësimit duhet të marrin trajnim plotësues me kohëzgjatje më të gjatë që do të ndërlidhet me përmbajtjet për secilën prej njësive modulare ndaras. Me këtë rast, mbështetje e veçantë u nevojitet mësimit për realizimin e përmbajtjeve, siç janë: Pushteti në funksion të qytetarëve; Roli shoqëror i administratës shtetërore dhe publike; Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm; Organizatat qytetare dhe grupet e përfaqësimit; Përballje me konflikte; Kontroll i sjelljes; Qytetari si konsumator dhe kursimtar.
- Nevojiten trajnime dhe mbështetje të mësimit për nxitjen e nxënësve për propozimin dhe ndërmarrjen e nismave me qëllim të përmirësimit të bashkësisë (të shkollës dhe më gjerë).
- Nevojiten trajnime të mësimit për zbatimin e metodave bashkëkohore interaktive të mësimit. Në trajnimet, mësimit duhet të trajnohen lidhur me atë se si gjatë orëve të krijojnë

atmosferë nxitëse dhe bashkëpunuese në të cilën nxënësit do të kenë mundësi që të përfshihen në mënyrë aktive gjatë gjithë procesit përmes: propozimit të ideve, parashtrimit të pyetjeve, dhënies së përgjigjeve, zgjidhjes së problemeve, hulumtimit, gjegjësisht përmes vizatimit, shkrimit, lëvizjes, dramatizimit, lojërave, etj.

- Mësimit duhet të trajnohen/të marrin mbështetje për përdorimin e metodave të ndryshme të notimit, duke përfshirë edhe teknikat e vetënotimit dhe notimit mes moshatarëshve, si veçanërisht të përshtatshme për zhvillimin e shkathtësive për nxënie vetëudhëzuese.

KONTROLL I NIVELIT TË ARRITJES SË REZULTATEVE NGA NXËNIA E ARSIMIT QYTETAR

- Nxënësit gjatë mësimit duhet të ndiqen dhe vlerësohen në përputhje me arritjen e tyre të standardeve që janë dhënë në programin mësimor, veçmas për çdo rezultat nga nxënia (ata përkrahajnë se çfarë pritet nga nxënësi të bëjë që të tregojë se është arritur rezultati i nxënies).
- Gjatë mësimit të ndiqen aktivitetet e nxënies, motivimi për nxënie, bashkëpunimi me të tjerët, raporti kritik ndaj nxënies dhe raporti krijues drejt asaj që është mësuar, gjegjësisht ndërtimi i qëndrimeve dhe mendimeve të tyre për çështje të caktuara nga materiali mësimor. Këto njohuri të përdoren për mbështetjen e nxënësve në nxënie. Me këtë rast të përdoren strategji dhe teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, duke përfshirë vetënotimin dhe vlerësimin e ndërsjellë.
- Në notën nuk duhet të ndikojnë qëndrimet e nxënësve për çështje të caktuara shoqërore, por notohet aftësia për analizë, interpretim dhe vlerësim.
- Secili nxënës duhet të jetë i informuar rregullisht për të arriturat e tyre, e gjithashtu informohen edhe prindërit për të arriturat e nxënësit. Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimit për mësimit dhe nxënien.



SHEMBUJ

Shkolla nga të cilat vijnë nxënësit kanë marrë pjesë në hulumtim

Shkollë e mesme	Vendi
Aco Ruskoski	Berovë
Shkolla shtetërore e muzikës	Manastir
Jane Sandanski	Manastir
Josip Broz Tito	Manastir
Taki Daskallo	Manastir
Bogdanci	Bogdanci
Jovçe Tesliçkov	Veles
Kole Nedellkovski	Veles
Josif Josifovski	Gjevgjeli
Gostivar-gjimnazi	Gostivar
Gostivar-mjekësi	Gostivar
Metodija Mitevski Brico	Dellçevë
Ilinden	Ilinden, Shkup
Kiro Spanxhov Bërko	Kavadar
Drita	Kërçovë
Mirko Milevski	Kërçovë
Gjorçe Petrov	Kriva Pallankë
Nace Buxhoni	Kumanovë
Sh. Naumi i Ohrit	Makedonski Brod
Vanço Pitoshevski	Ohër
Sh. Naumi i Ohrit	Ohër
Kuzman Josifovski Pitu	Prilep
Riste Risteski - Riçko	Prilep
Car Samoil	Resnjë
Koço Racin	Shën Nikollë
8 Shtator	Shkup
Arseni Jovkov	Shkup
Boro Petrushevski	Shkup
Vllado Tasevski	Shkup
Gjeorgi Dimitrov	Shkup
Dimitar Vllahov	Shkup
Zdravko Cvetkovski	Shkup
Zef Lush Marku	Shkup
Ilija Nikollovski Lluj	Shkup
Josip Broz Tito	Shkup
Koço Racin	Shkup
Llazar Liçenovski	Shkup
Llazar Tanev	Shkup
Mihajllo Pupin	Shkup
Pançe Karagjozov	Shkup
Dr. Ibrahim Temo	Strugë
Niko Nestor	Strugë
Nikolla Karev	Strumicë
7 Marsi	Tetovë
8 Shtatori	Tetovë
Mosha Pijade	Tetovë
Nikolla Shtejn	Tetovë
Jane Sandanski	Shtip
Kole Nehtenin	Shtip
Sllavço Stojmenski	Shtip

Shkolla nga të cilat vijnë mësimdhënësit që kanë marrë pjesë në hulumtim

Shkollë e mesme	Vendi
Aco Ruskovski	Berovë
Dr. Jovan Kallauzi	Manastir
Jane Sandanski	Manastir
Kuzman Shapkarev	Manastir
Taki Daskallo	Manastir
Bogdanci	Bogdanci
Dimitrija Çupovsk	Veles
Jovçe Tesliçkov	Veles
Koço Racin	Veles
Vanço Përke	Vinicë
Josif Josifovski	Gjevgjeli
Gostivar-gjimnazi	Gostivar
Gostivar-ekonomik	Gostivar
Gostivar-mjekësi	Gostivar
Metodija Mitevski Brico	Dellçevë
Kërste P. Misirkov	Demir Hisar
Gjorçe Petrov	Kavadar
Mirko Mileski	Kërçovë
Gjoshko Vikentiev	Koçanë
Lupço Santov	Koçanë
Mitko Penxhukliski	Kratovë
Gjorçe Petrov	Kriva Pallankë
Goce Dellçev	Kumanovë
Nace Bugjoni	Kumanovë
Sami Frashëri	Kumanovë
Mavrovë - Rostushe	Mavrovë dhe Rostushe
Mile Janevski Xhingar	Makedonska Kamenicë
Sh. Naumi i Ohrit	Makedonski Brod
Sh. Qirili dhe Metodi	Negotinë
Naumi i Ohrit	Ohër
Sh. Qirili dhe Metodi	Ohër
Gjorçe Petrov	Prilep
Kuzman Josifovski Pitu	Prilep
Mirçe Acev	Prilep
Riste Risteski – Riçko	Prilep
Kosta Susinov	Radovish
Car Samoili	Resnjë
Koço Racin	Shën Nikollë
Arseni Jovkov	Shkup
Vëllezërit Milladinov	Shkup
Vasill Antevski Dren	Shkup
Gjeorgi Dimitrov	Shkup
Dimitar Vllahov	Shkup
Zdravko Cvetkovski	Shkup
Zef Lush Marku	Shkup
Josip Broz Tito	Shkup
Koço Racin	Shkup
Llazar Tanev	Shkup
Marija Kiri Skllodovska	Shkup
Mihajllo Pupin	Shkup
Nikolla Karev	Shkup
Orce Nikollov	Shkup
Pançe Arsovski	Shkup
Pançe Karagjozov	Shkup
Cvetan Dimov	Shkup
Niko Nestor	Strugë
Dimitar Vllahov	Strumicë
Jane Sandanski	Strumicë
Nikolla Karev	Strumicë
7 Marsi	Tetovë
8 Shtatori	Tetovë

Goce Stojçevski	Tetovë
Mosha Pijade	Tetovë
Nikolla Shtejn	Tetovë
Dimitar Mirasçiev	Shtip
Jane Sandanski	Shtip
Kole Nehtenin	Shtip
Sllavço Stojmenski	Shtip

Ekzemplar i nxënësve i praqitur sipas llojit/profilit të arsimit (gjimnaz/profesional) në të cilin mësojnë

Kategori të përgjigjeve	Numër	Përqindje
gjimnaz	115	15,7
elektroteknikë	124	16,9
ekonomi-juridik dhe tregti	101	13,8
shëndetësi	79	10,8
ndërtimtari-gjeodezi	62	8,5
makineri	53	7,2
hotelieri– turizëm	41	5,6
komunikacion	28	3,8
tekstil-lëkurë	6	0,8
gjimnaz i sportit	5	0,7
bujqësi – veterineri	4	0,5
gjeologji-xehtari dhe metalurgji	1	0,1
grafikë	4	0,5
kimi – teknologji	2	0,3
ushqimore	1	0,1
Nuk ka përgjigje	107	14,6
Gjithsej përgjigje	733	100

Ekzemplar i mësimdhënësve i praqitur sipas llojit/profilit të arsimit (gjimnaz/profesional) në të cilin ligjërojnë

Kategori e përgjigjeve	Numër	Përqindje
gjimnaz	25	14,7
ekonomi-juridik dhe tregti	18	10,6
tekstil-lëkurë	17	10
elektroteknikë	17	10
shëndetësi	16	9,4
komunikacion	11	6,5
makineri	11	6,5
hotelieri– turizëm	9	5,3
bujqësi – veterineri	8	4,7
kimi – teknologji	8	4,7
shërbime personale	7	4,1
gjeologji-xehtari dhe metalurgji	6	3,5
ndërtimtari-gjeodezi	5	2,9
grafikë	5	2,9
gjimnaz i sportit	4	2,4
ushqimore	3	1,8
Gjithsej përgjigje	170*	100

*Ekzemplarin e përbëjnë 106 mësimdhënës, por janë marrë 170 përgjigje, meqë një mësimdhënës mund të ligjërojë në më shumë profesione.

